

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO Gjykatë Kushtetuese / Ustavni Sud / Constitutional Court	
Niveli origjinal / Original / Original DRLSA	Nr. Protokoll / Prot. No. 766
Nr. i faqesve / No. pages 32	Data / Datum / Date 30.04.2020

KËRKESA

Pranuar / Primaljeno 30 APR 2020 No. [] / [] Kosova
--

Në bazë të Nenit 113.2 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Rregullit 39 par.1 pika b) dhe c), lidhur me Rregullin 67, të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese, Nr. 01/2018, në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, deputetët e poshtëshënuar parashetrojnë kërkesë:

Lidhur me

Vlerësimin e kushtetutshmërisë së Dekretit nr.24/2020 të Presidentit të Republikës së Kosovës



telegraf.com

II. PËRSHKRIMI I PËRMBLEDHUR I FAKTEVE

1. Me datë 25 mars 2020, me iniciativë të 44 deputetëve, u mbajt seanca e Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku në rend të ditës ishte “Mocioni për mosbesimin ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës”.
2. Kuvendi me 82 vota për, 32 kundër dhe 1 abstenim, votoi mocionin e mosbesimit të Qeverisë.
3. Më 2 prill 2020, Presidenti duke u bazuar në nenin 95 të kushtetutës ka kërkuar emrin e mandatarit nga LV.
4. Më 25 mars 2020 është votuar mocioni i suksesshëm i mosbesimit ndaj Qeverisë.
5. Më 30.03.2020, Presidenti ka ftuar në kundërshtim me Kushtetutën të gjitha partitë politike dhe koalicionet për konsultime për formimin e Qeverisë.
6. Më 1.04.2020, Kryetari i Lëvizjes VETËVENDOSJE! i kthen përgjigje Presidentit përmes të cilës potencon se “konsultimet” me të gjitha partitë politike dhe koalicionet nuk kanë bazë kushtetuese.
7. Më 02.04.2020 Presidenti i Kosovës kërkon nga Kryetari i Lëvizjes VETËVENDOSJE! që të propozojë kandidatin e ri për formimin e Qeverisë. Presidenti i Kosovës më 10.04.2020 kërkon nga Kryetari i Lëvizjes VETËVENDOSJE! kandidatin.
8. Më 13.04.2020 Kryeministri i dërgon letër përmes të cilës theksohet se veprimi i Presidentit bie në kundërshtim me paragrafin 84 të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KO 103/14. Po ashtu përmes kësaj letre i rikujtohet se pas mocionit të suksesshëm të mosbesimit, përmes të cilit është shkarkuar Qeveria e Republikës së Kosovës, Presidentit nuk i krijohet hapësirë që të luaj rolin e një akteri politik duke tentuar të imponojë vullnetin e tij në jetën politike. Presidentit të Republikës së Kosovës, si organ kushtetues, një mocion mosbesimi i jep të drejtën që të përmbush vetëm një veprim të përcaktuar nga kushtetutëbërësi.

9. Më 15.04.2020 Presidenti në kundërshtim me Kushtetutën dhe aktgjykimin insiston, duke ju referuar paragrafit 87 të aktgjykimit, duke e interpretuar se mospropozimi mund të cilësohet si refuzim.
10. Më 17.04.2020 Kryetari i Lëvizjes VETËVENDOSJE! përmes letrës Ref. 122/2020 i përgjigjet se nuk e refuzojmë kërkesën për mandatar.
11. Më 17.04.2020 Presidenti kërkon sërish kandidatin për kryeministër, kurse më 22.04.2020 në letrën Nr.380, jashtë kompetencave të tij kushtetuese, duke caktuar arbitrarisht afate që nuk i parashih Kushtetuta, konstaton se Lëvizja VETËVENDOSJE! nuk e ka shfrytëzuar të drejtën për të propozuar kandidatin e ri për ta formuar Qeverinë.
12. Më 22.04.2020 Kryetari i Lëvizjes VETËVENDOSJE! i dërgon letër Presidentit përmes të cilës konstaton se përkundër që në asnjë rast nuk e kemi refuzuar as kërkesën dhe as propozimin e mandatarit, Presidenti jashtë kompetencave kushtetuese të tij konstaton se Lëvizja VETËVENDOSJE! nuk e ka shfrytëzuar të drejtën për propozimin e kandidatit të ri për të formuar Qeverinë. *“Kushtetuta e Republikës nuk parashih një kompetencë të tillë të Presidentit për të vlerësuar apo konstatuar shfrytëzimin apo mosshfrytëzimin e të drejtës për të propozuar mandatarin. Përveç kësaj, Kushtetuta e as Aktgjykimi 103/14 nuk kanë përcaktuar as afatin për një gjë të tillë. Kushtetuta çfarë parash në këtë rast është caktimi i mandatarit vetëm pas propozimit nga partia ose koalicioni që ka fituar shumicën absolute apo relative, siç përcaktohet edhe në piken 84 të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese. Andaj, bazuar në rolin dhe funksionin si President, ju nuk keni të drejtë e as autorizim kushtetues për të konstatuar se kemi refuzuar propozimin e kandidatit për kryeministër kur nuk e kemi bërë këtë; ju nuk e keni në mandat e kompetencë që të përcaktoni përtej Kushtetutës se si e çfarë do të jetë Qeveria, siç keni bërë këtyre ditëve në deklaratimet publike; dhe me keqardhje konstatojmë se ende nuk na jeni përgjigjur se në bazë të cilës pikë të nenit 95 po veproni dhe po na drejtoheni.”*
13. Me datë 22prill 2020, Presidenti i Republikës së Kosovës, duke mos pritur emrin e propozuar nga partia politike e cila i ka fituar zgjedhjet dhe njëkohësisht në kundërshtim me Kushtetutën, konkretisht duke u bazuar serish në nenin 95 të Kushtetutës në mënyrë jopublike (Letra e Presidentit drejtuar LDK-së asnjëherë nuk është bërë publike) me shkrim ka kërkuar nga LDK, si subjekti politik i cili është renditur i dyti në zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare të datës 6 tetor 2019, emrin e kandidatit për Kryeministër.
14. Me datë 30 prill 2020, LDK ka propozuar emrin e kandidatit për kryeministër, dhe të njëjtën ditë Presidenti i Republikës ka nxjerrë dekretin nr. 24/2020me të cilin mandaton kandidatin për kryeministër nga radhët e LDK-së.

III. BAZA LIGJORE E KËRKESËS DHE ARSYETIMI I SAJ

15. Kërkesa bazohet në nenin 113 paragrafi 2(1) i Kushtetutës dhe nenet 29 dhe 30 të Ligjit të cilat shprehimisht përcaktojnë:

“Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

(...)

Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:

çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën;”

16. Ligji Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, neni 29 dhe 30 në lidhje me nenin 113.2 (1), të Kushtetutës përcakton se:

“Kërkesa e ngritura në pajtim me nenin 113 paragrafi 2 të Kushtetutës do të parashtrihen nga një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria ose nga ana e Avokatit të Popullit.

Kërkesa e ngritur kundër aktit të kontestuar sipas nenit 113 paragrafi 2 të Kushtetutës duhet të specifikojë, inter alia, nëse i tërë akti i kontestuar apo pjesë të veçanta të këtij akti konsiderohen të jenë në kundërshtim me Kushtetutën.

Kërkesa do të specifikojë kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar.

Afatet Kërkesa e ngritur në pajtim me nenin 29 të këtij ligji duhet të parashtrihen brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar.”

17. Rregullorja e Punës e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr 01/2018, në nenin 67 përcakton se:

“Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me nenin 113.2 (1) dhe (2) të Kushtetutës dhe me nenet 29 dhe 30 të Ligjit.

Kur një kërkesë parashtrohet në pajtim me nenin 113.2 të Kushtetutës, pala e autorizuar duhet të tregojë, inter alia, nëse përmbajtja e plotë e aktit të kontestuar ose pjesë të caktuara dhe cilat pjesë të aktit të përmendur konsiderohen të jenë në papajftueshmëri me Kushtetutën.

Kërkesa specifikon kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar.

Kërkesa sipas këtij rregulli duhet të dorëzohet brenda një periudhe prej gjashtë (6) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar.”

18. Deputetët e lartshënuar të grupit parlamentar të Lëvizja VETËVENDOSJE!, duke u mbështetur në dispozitat kushtetuese ligjore dhe nënligjore të lartcekura kanë plotësuar të gjitha kriteret formalo-kushtetuese, ligjore dhe nënligjore për të qenë palë e autorizuar në kuptim të kontestimit të dekretit të nxjerrë nga Presidenti i Republikës së Kosovës. Andaj, numri i caktuar deputetëve brenda afatit ligjor parashtrorinë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Dekretit nr. 24/2020 të Presidentit të Kosovës.

IV SHKELJET E PRETENDUARA TË KUSHTETUTËS

19. Deputetët e Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE! kontestojnë kushtetutshmërinë e Dekretit nr. 24/2020 të Presidentit të Kosovës, dhe pretendojnë se ky dekret shkelë nenet kushtetuese si në vijim:

Nenin 84.par.4

“Presidenti nxjerrë dekrete në pajtim me këtë kushtetutë.”

82 par.2

“Kuvendi shpërndaheh në këto raste:

{...}

Kuvendi mund të shpërndaheh nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pas votimit të suksesshëm të mosbesimit të Qeverisë.”

Neni 4 par.1

“Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë.”

Nenin 84.14

“Presidenti cakton mandatarin për formimin e Qeverisë, pas propozimit të partisë politike ose të koalicionit, që përbën shumicën e Kuvendit.”

Nenin 95 (Zgjedhja e Qeverisë)

“1. Pas zgjedhjeve, Presidenti i Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë.

2. Kandidati për Kryeministër, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas emërimit, paraqet përbërjen e Qeverisë para Kuvendit të Kosovës dhe kërkon miratimin nga ana e Kuvendit.

3. Qeveria konsiderohet e zgjedhur nëse merr shumicën e votave të të gjithë deputeteve të Kuvendit të Kosovës.

4. Nëse përbërja e propozuar e Qeverisë nuk merr shumicën e votave të nevojshme, Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda dhjetë (10) ditësh emëron kandidatin tjetër sipas së njëjtës procedurë. Nëse as herën e dytë nuk zgjidhet Qeveria, atëherë Presidenti i Kosovës i shpall zgjedhjet, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se dyzet (40) ditë nga dita e shpalljes së tyre.

5. Nëse Kryeministri jep dorëheqjen ose për arsye të tjera, posti i tij/saj mbetet i lirë, Qeveria bie, dhe Presidenti i Republikës së Kosovës, në konsultim me partitë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, mandaton kandidatin e ri, për të formuar Qeverinë.

6. Anëtarët e Qeverisë pas zgjedhjes, japin betimin para Kuvendit. Teksti i betimit rregullohet me ligj.”

Pranueshmëria e Kërkesës (Legjitimiteti i Palës)

20. Grupi Parlamentar i përbërë nga 30 deputetë të Lëvizja VETËVENDOSJE!, siç u cek edhe më lartë, është palë e autorizuar për të parashtruar këtë kërkesë, në përputhje me nenin 13.2 (1), të Kushtetutës së Kosovës. Për më tepër, çështja e ngritur nga deputetët në fjalë është çështje kushtetuese, sepse konteston kushtetutshmërinë e një DEKRETI të një autoriteti publik brenda afatit të caktuar ligjor, i cili pretendohet se cenon nenet kushtetuese të përshkruara në pikën III .

V. Argumentimi dhe arsyeshmëria e pretendimeve kushtetuese ndaj mospërputhshmërisë në tërësi të Dekretit. nr. 24/2020 i datës 30 prill 2020 të Presidentit të Republikës së Kosovës, me Kushtetutën e Kosovës

21. Më 20 mars 2020, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, i mbështetur edhe nga deputetët të tjerë, dorëzuan në Kryesi të Kuvendit kërkesën për mocion

mosbesimi ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës. Më 25 mars 2020, Kuvendi i Kosovës votoi për mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë me 82 vota për, 32 kundër dhe 1 abstenim. Sipas nenit 100 par. 4 të Kushtetutës konsiderohet se mocioni i mosbesimit është pranuar, nëse për të kanë votuar shumica e të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Meqenëse, për mocionin e mosbesimit është plotësuar kriteri i paraparë në paragrafin 4 të nenit 100, atëherë sipas par. 6 të të njëjtit nen, mocioni i mosbesimit është votuar suksesshëm ndaj qeverisë në tërësi dhe kësaj qeverie konsiderohet në dorëheqje.

22. Pas krijimit të kësaj situata kushtetuese, Presidenti si përfaqësues i unitetit të popullit përmes kompetencave të tij kushtetuese aktivizohet në funksion të realizimit të statusit të tij të përcaktuar në nenin 83 të Kushtetutës “*Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës.*” Nga kjo dispozitë kushtetuese kuptohet se Presidenti i Kosovës nuk lejohet t’i përfaqësojë interesat grupore ose politike partiake, por i përfaqëson të gjithë së bashku, që i jep kuptim substancial përfaqësimit të unitetit të popullit të një shteti. Mbi bazën e këtij statusi, Presidentit të Kosovës i janë dhënë kompetenca kushtetuese për të materializuar rolin e tij si pushtet balancues apo “mediator institucionesh” apo pushtet asnjans. Forcimi i statusit të tij të përcaktuar me nenin 83 të kushtetutës, bëhet duke qëndruar jashtë ndarjes së pushteteve përfshirë edhe ndalimin e ushtrimit të funksioneve aktive në drejtimin politik të vendit. Mbi argumentimin kushtetues dhe funksional të statusit të Presidentit të vendit, ushtrimi i kompetencave të tij, të shpërndarë në kapituj të ndryshëm të Kushtetutës, duhet të jetë në përputhje me funksionin e tij në kuptim të ushtrimit konkret, të saktë dhe të drejtë të kompetencave kushtetuese të cilat i përgjigjen situatës së krijuar kushtetuese.

23. Në këtë kuptim, pas votimit të suksesshëm mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë në tërësi, Presidenti i Republikës së Kosovës, sipas nenit 84 par. 14 lidhur me nenin 95 par. 4, pa pritur propozimin për mandatar të partisë politike e cila i ka fituar zgjedhjet, ka caktuar për mandatar kandidatin e caktuar për kryeministër nga radhët e partisë politike e cila ishte renditur e dyta në zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare të 6 tetorit 2019. Ky dekret antikushtetues i ka paraprirë letërkëmbimeve të datës 22 prill 2020 dhe 29 prill 2020 (Letrat nuk janë bërë publike) në mes Presidentit dhe LDK-së. Kësaj nxjerrje e këtij dekreti është në kundërshtim të plotë me nenin 84 par. 4 lidhur me nenin 82 par. 2 dhe nenin 84 par.14 të Kushtetutës së Kosovës.

24. Neni 84 par. 4 thekson se Presidenti “*nxjerr dekrete në pajtim me këtë Kushtetutë;*”. Në lidhje me këtë, pas votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë, qeveria konsiderohet në dorëheqje, dhe në këtë kuptim, Presidenti është dashur përmes dekretit të shpërndajë Kuvendin sipas nenit 82 par. 2 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës. Pra, Presidenti nuk ka asnjë bazë kushtetuese të aktivizojë nenin 95 të Kushtetutës së Kosovës, e aq më pak nenin 95 par. 4 të Kushtetutës, për faktin se në mes nenit 100 par. 6 dhe nenit 95 mungon ura lidhëse e mbuluar me normë kushtetuese në

mënyrë të shprehur. Me fjalë tjera, nuk ka asnjë dispozitë kushtetuese në formë të shprehur që ia lejon Presidentit aktivizimin e nenit 95 të Kushtetutës përmes dekretit. Krejt kjo për faktin se nuk jemi në situatën para zgjedhjes së qeverisë, por në situatën kushtetuese pas krijimit dhe shkarkimit të qeverisë së Kosovës përmes votimit të mocionit të mosbesimit në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Andaj, ura lidhëse e mbuluar me normë kushtetuese në mes nenit 100 par. 6 dhe nenit 82 par. 2 ekziston në formë të shprehur, për faktin se ky nen i lejon presidentit shpërndarjen e Kuvendi si pasojë e votimit të një mocioni të suksesshëm ndaj qeverisë. Kësisoj, jo rastësisht në tërësinë e përmbajtjes së Kushtetutës mocioni i mosbesimit përmendet vetëm në nenin 100 dhe në nenin 82 par. 2. Krejt kjo për faktin e mosdëmtimit të legjitimitetit, si bazë themelore dhe e pakapërcyeshme, e cila rrjedh nga fuqia mbizotëruese politike brenda parlamentit dhe i ka rrënjët në forcën politike që i fiton zgjedhjet.¹ Kjo dispozitë kushtetuese krijon portë kushtetuese dalëse për të kthyer pushtetin popullit (vox), në mënyrë që të rilegjitimohen përfaqësuesit e popullit në institucionet e ardhshme kushtetuese.

25. Aktivizimi i nenit 95, sidomos paragrafit 4 të këtij neni, përmes dekretit të Presidentit të Kosovës, është kundërkushtetues për faktin se, pas votimit të mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë nuk është mbuluar me normë kushtetuese në formë të shprehur. Pra mungesa e kësaj ure lidhëse në formë të shprehur përmes normës kushtetuese e cila e aktivizon nenin 95² dhe më pastaj nenin 95.4 përmes nenit 84 par. 4, pas zbatimit të nenit 100 par. 6 e bën kundërkushtetues dekretin e Presidentit të Kosovës. Pra, për të argumentuar me thellë çështjen e vakumit kushtetues në aktivizimin e nenit 95 dhe 95 par. 4 të Kushtetutës së Kosovës, jemi të detyruar që përmes kushtetutave të vendeve të rajonit dhe shteteve të BE-së, të argumentojmë se si nuk mungojnë dispozita kushtetuese në formë të shprehur në krijimin e qeverive të reja pas mocionit mosbesimit ndaj qeverive aktuale.

Kushtetuta e Kroacisë

Nenit 116 par. 7

“Kryeministri dhe Qeveria duhet të deklarojnë dorëheqjen nëse mocioni për mosbesim ndaj Kryeministrit ose Qeverisë bëhet i suksesshëm.

Nëse brenda 30 ditëve një mandatar i ri nuk i votohet kabineti qeveritar i propozuar, atëherë Kryetari i Kuvendit duhet të njoftojë Presidentin.

¹ Shi Akgjykmim 103/14, pika 49.

² Shih më shumë letërkëmbimin në mes Kryetarit të LVV-së dhe Presidentit

Menjëherë pas këtij njoftimi Presidenti duhet të merr vendim për shpërndarjen e Kuvendit dhe njëkohësisht të thërras zgjedhje te reja.”

Kushtetuta e Sllovenisë

Neni 116

“Parlamenti mund të iniciojë mocion mosbesimi ndaj qeverisë vetëm duke zgjedhur një Kryeministër të ri me shumicën e votave, i cili pastaj duhet të propozojë kabinetin e ti.”

Kushtetuta Republikës Federale Gjermane

Neni 67 par. 1

“Parlamenti mund të iniciojë mocion mosbesimi ndaj Kryeministrit (Bundeskanzler) vetëm duke zgjedhur një Kryeministër të ri me shumicën e votave dhe duke kërkuar nga Presidenti që ta shkarkojë Kryeministrin e vjetër. Presidenti duhet të veprojë sipas kërkesës.”

Kushtetuta e Republikës së Greqisë

Neni 38 par. 1

“Presidenti i Republikës e shkarkon Qeverinë nëse kjo jep dorëheqjen, ose mocioni për mosbesim ndaj Qeverisë bëhet i suksesshëm sipas Nenit 84. Në raste të tilla, dispozitat e paragrafëve 2, 3 dhe 4 të neni 37 zbatohen në mënyrë analoge.”

Neni 37

Presidenti i Republikës emëron Kryeministrin dhe me rekomandimin e tij emëron dhe shkarkon anëtarët e kabinetit dhe sekretarët.

Udhëheqësi i partisë që ka shumicën absolute të vendeve në Parlament emërohet Kryeministër. Nëse asnjë palë nuk ka shumicën absolute, Presidenti i Republikës do t'i japë udhëheqësit të partisë me shumicë relative një mandat në mënyrë që të konstatojë mundësinë e formimit të një qeverie që gëzon besimin e Parlamentit.

Nëse kjo mundësi nuk mund të konstatohet, Presidenti i Republikës do t'i japë mandatin udhëheqësit të partisë së dytë më të madhe në Parlament, dhe nëse kjo dëshmon të jetë e pasuksesshme, udhëheqësit të partisë së tretë më të madhe në Parlament. Secili mandat do të jetë në fuqi për tre ditë.

Nëse të gjitha mandatet rezultojnë të pasuksesshme, Presidenti i Republikës thërret të gjithë drejtuesit e partive, dhe nëse konfirmohet pamundësia për të krijuar një kabinet që gëzon besimin e Parlamentit, ai do të përpiqet të formojë një kabinet të përbërë nga të gjitha palët në Parlamentin me qëllim të mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare.”

Kushtetuta e Serbisë

Neni 130

“Një votim mosbesimi ndaj Qeverisë ose një anëtar i veçantë të Qeverisë mund të kërkohej nga të paktën 60 deputetë.

Nëse Asambleja Kombëtare (Parlamenti) kalon një votë mosbesimi në Qeveri, Presidenti i Republikës është i detyruar të fillojë procedurat për zgjedhjen e Qeverisë së re.

Nëse Asambleja Kombëtare nuk zgjedh Qeverinë e re brenda 30 ditëve nga data e votimit të mosbesimit, Presidenti i Republikës është i detyruar të shpërndajë Asambleenë Kombëtare dhe të caktojë zgjedhjet.”

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 104

“1. Kryeministri ka të drejtë t'i paraqesë Kuvendit mocion besimi ndaj Këshillit të Ministrave. Në rast se mocioni i besimit votohet nga më pak se gjysma e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, Kryeministri, brenda 48 orëve nga votimi i mocionit, i kërkon Presidentit të Republikës shpërndarjen e Kuvendit.”

Neni 105

“Një e pesta e deputetëve ka të drejtë të paraqesë për votim në Kuvend një mocion mosbesimi ndaj Kryeministrit në detyrë, duke propozuar një Kryeministër të ri.”

Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë

Neni 9

9.1.26

Kuvendi vendos mbi mocionet e mosbesimit të Qeverisë

9.3.10 (Mocioni i Vetëbesimit)

Kuvendi mund të mos ia jep votëbesimin Qeverisë vetëm nëse me një shumicë të deputetëve të tij zgjedh njëkohësisht një Kryeministër të ri bashkë me listën e ministrave të propozuar nga ai ose ajo.

9.3.11

Mandati i Qeverisë që largohet përfundon me zgjedhjen e Kryeministrit dhe ministrave të rinj

26. Krahasimi i strukturës së kushtetutave të lartpërmendura dhe formulimit të normave kushtetuese në shtetet tjera, nxjerrë në sipërfaqe veçantinë dhe dallimin që hasim në Kushtetutën e Republikës së Kosovës në krahasim me kushtetutat e shteteve tjera.
27. Përderisa në shtetet tjera, në mënyrë shprehimore parashihen hapat e mëtutjeshëm të cilët duhet t'i merr Kuvendi që deputetët të shfrytëzojnë të drejtën e tyre për të parandaluar shpërndarjen e Kuvendit, në Kushtetutën e Kosovës nuk parashihet asnjë procedurë tjetër pas një mocioni të suksesshëm të mosbesimit, por vetëm shpërndarja e Kuvendit.
28. Mungesa e dispozitave kushtetuese në formë të shprehur siç parashihen në kushtetutat e vendeve të ndryshme, bën që dekreti i presidentit të jetë në kundërshtim me Kushtetutën në dy aspekte. E para dekreti ka aktivizuar nenin 95 dhe 95 par. 4 të Kushtetutës pa dispozitë kushtetuese në formë të shprehur që do të mund të dërgonte në aktivizimin e një neni të fillë. Pra në këtë rast, norma kushtetuese ka dërguar në rrugë njëdrejtimëshe në nenin 82. 2 të Kushtetutës. Kësisoj, norma kushtetuese në rastin konkret nuk lejon që neni 95 të zbatohet serish pas shkarkimit të qeverisë, për shkak të mungesës së dispozitës kushtetuese që mund të cilësohen si urë lidhëse kushtetuese në mes nenit 100 dhe nenit

95. Ajo që nuk mund të parashihet me kushtetutë, nuk mund të zbatohet.³ E dyta, ka të bëjë me faktin se Kushtetuta e Kosovës, lidhur me këtë rast parasheh dispozita të qarta në lidhje me ushtrimin e kompetencave të Presidentit për të zgjidhur situatën aktuale kushtetuese. Në lidhje me këtë, Presidenti ka nxjerrë dekret në kundërshtim me nenin 82. 2 të Kushtetutës, e cili nen është i lidhur natyrshëm me nenin 100 par. 6 të Kushtetutës. Sepse vetëm në këtë formë ruhet dhe mbrohet legjitimiteti demokratik, i cili nuk mund të shmanget me norma kushtetuese inekzistente. Në lidhje me këtë edhe praktika e nxjerrjes së dekretëve nga Jakup Krasniqi, u.d. i Presidentit të Republikës së Kosovës në vitin 2010, dhe Presidenti Hashim Thaçi në vitin 2017, vërtetojnë qartë se pas mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë, rruga e vetme kushtetuese e veprimit është shpërndarja e Kuvendit përmes nenit 82. 2 të Kushtetutës.

29. Praktika e nxjerrjes së dekretëve në rrugën e duhur kushtetuese pas votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit, ka të bëjë me respektimin demokracisë *vox populi* (zëri i popullit), që do të përfaqësohet në organin legjislativ. Pra ky organ zgjedh qeverinë (shih nenin 65.8 të kushtetutës), e cila rrjedh nga fuqia mbizotëruese dhe politike brenda parlamentit dhe i ka rrënjët në forcën politike që fiton zgjedhjet. Kjo mund të jetë një fitore absolute apo relative.⁴ Kësisoj ky legjitimitet demokratik nuk mund bartet te partitë që janë renditur pas vendit të parë në zgjedhjet e 6 tetorit 2019, për të krijuar qeveri pa fituesin e zgjedhjeve. Çdo përpjekje për të ndryshuar legjitimitetin demokratik, të cilin e bartë partia fituese e zgjedhjeve, me dispozita kushtetuese që nuk parashihen në kushtetutë, përbën shkelje kushtetuese. Prandaj, dekreti i cili ka bërë aktivizimin e nenit 95, konkretisht, dhënia e mandatit sipas nenit 95 par. 4, partisë së dytë në zgjedhje, përbën mospërputhshmëri me nenin 84 par. 4 lidhur me nenin 82 par. 2 të Kushtetutës.

30. Për të vazhduar më tej me argumentimin e mëtutjeshëm të cenimit të normave kushtetuese përmes nxjerrjes së këtij dekreti, duhet të analizojmë nenin 9.3.10 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje e Përkohshme në Kosovës⁵, i cili thekson se “Kuvendi mund të mos ia jep votëbesimin Qeverisë vetëm nëse me një shumicë të deputetëve të tij zgjedh njëkohësisht një Kryeministër të ri bashkë me listën e ministrave të propozuar nga ai ose ajo”, ndërsa neni 9.3.11 thekson se “Mandati i Qeverisë që largohet përfundon me zgjedhjen e Kryeministrit dhe ministrave të rinj.” Përcaktohet

³ Shih me shumë Aktgjykimin 119/14. Në pikën 126 të këtij aktgjykimi theksohet se Gjykata vëren se askund në Kushtetutë nuk parashihet që dështimi në zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit do të shkaktonte mbajtjen e zgjedhjeve të reja parlamentare.

⁴ Shih me shumë aktgjykimin nr 103/2014.

⁵ Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovës, në nenin 9.3.10 dhe në nenin 9.3.11, përcakton qartë se brenda këtij neni është i vendosur koncepti i votëbesimit dhe mosbesimit. Koncepti i mosbesimit mund të kuptohet nga neni 9.3.11 i cili thekson “Mandati i Qeverisë që largohet përfundon me zgjedhjen e Kryeministrit dhe ministrave të rinj”. Shprehimisht përcakton përfundimin e mandatit të një qeverie si pasojë e zgjedhjes së Kryeministrit dhe ministrave të rinjë.

qartë se votimi i mocionit të suksesshëm është i lidhur me zgjedhjen e Kryeministri dhe ministrat të rinj. Në këtë aspekt, sipas këtyre dispozitave, vërehet qartë se pas mocionit të suksesshëm të mosbesimit nuk përfshihet asnjë organ tjetër kushtetues. Ndryshe nga Korniza Kushtetuese, Kushtetuta e lejon Presidentin e Kosovës të përfshihet në këtë situatë kushtetuese, vetëm për të zbatuar nenin 82.2 të Kushtetutës e cila ka të bëjë me shpërndarjen e Kuvendit. Ndryshe nga që ishte përcaktuar në Kornizën kushtetuese, Kushtetuta nuk përcakton në asnjë dispozitë kushtetuese që Presidenti mund të aktivizojë nenin 95 të Kushtetutës për zgjedhjen e qeverisë së re pas mocionit të suksesshëm të mosbesimit. Kushtetuta ka përcaktuar qartë nenin 82 par. 2 si portën e vetme kushtetuese për të zhbllokuar institucionet kushtetuese të Republikës së Kosovës.

31. Referimi në Kornizën Kushtetuese me qëllim të kuptimit të zhvillimit të formës së legjitimitetit, organizimit dhe funksionimit të organeve shtetërore është e njohur edhe në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Kësisoj me rastin e nxjerrjes së Aktgjykimit në rastin NR. KO 29/11, Gjykata për të nxjerrë kuptimin e vërtetë të normës kushtetuese, kishte krahasuar ndryshimet që vëreheshin në tekstin e Kushtetutës së Kosovës në krahasim me Kornizën Kushtetuese.
32. Në dritën e këtyre argumenteve, theksojmë se ndryshimi i llojit të mocionit të mosbesimit, pra kalimi nga një mocion konstruktiv mosbesimi në llojin e mocionit desktruktiv të mosbesimit, është bërë në mënyrë që të kuptohet qartë se shkarkimi i Qeverisë ka për pasojë edhe shpërndarjen e Kuvendit dhe shpalljen e zgjedhjeve të reja.
33. Për këtë arsye, deri më sot, dispozitat kushtetuese janë jetësuar natyrshëm dhe çdo mocion mosbesimi është përcjellur me shpërndarjen e Kuvendit nga Presidenti në të njëjtën ditë.
34. Neni 100 par. 6 i Kushtetutës është natyrshëm i lidhur në nenin 82 par. 2 të Kushtetutës, që thekson se: *“Kuvendi mund të shpërndahet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pas votimit të suksesshëm të mosbesimit të Qeverisë”*. Kjo dispozitë kushtetuese, i lejon presidentit të shpërndajë Kuvendin e Kosovës në momentin që mocioni ndaj qeverisë është i suksesshëm dhe kjo për këto arsye:
35. E para, Neni 4 i Kushtetutës përcakton qartë se *“Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë.”* Sipas këtij parimi, që njëkohësisht cilësohet edhe si vlerë e rendit kushtetues të Kosovës, kuvendi ushtron pushtetin legjislativ, qeveria pushtetin ekzekutiv, ndërsa Presidenti, sipas paragrafit 3 të po të njëjtit nen, *“është përfaqësuesi legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë.”* Mbi bazën e këtij neni, Gjykata Kushtetuese në aktgjykimet KO 29/12 dhe KO 48/12 thekson se

“mandati i Presidentit të Republikës është i pacenueshëm për të siguruar respektim të parimit të ndarjes së pushteteve dhe për ta ruajtur sigurinë në rendin juridik dhe kushtetues.” Sigurimi dhe respektimi i ndarjes së pushteteve, kontrolli dhe balancimi i tyre, duhet interpretuar në kuptimin ekstensiv në drejtim të asaj se ky respektim dhe sigurim nuk duhet të limitohet vetëm në rastin e funksionimit mandator të institucionit legjislativ dhe ekzekutiv. Ky parim, me të gjitha elementet e tij duhet të vlejë edhe në situatën aktuale kushtetuese. Në situatën aktuale kur qeveria si pushtet ekzekutiv është jashtë mandatit, për shkak shkarkimit të saj nga Kuvendi, ndërsa Kuvendi si pushtet legjislativ është duke funksionuar brenda mandatit të vet kushtetues, kemi një disbalancim dhe moskontrollim ndaj njëri-tjetrit. Për këtë arsye Presidenti në mungesë të normave kushtetuese të cilat e aktivizojnë nenin 95, është i detyruar sipas nenit 4 të Kushtetutës të respektojë dhe sigurojë ndarjen e pushteteve, kontrollin dhe balancimin e tyre në kuptim të shpërndarjes së Kuvendit. Sepse kompetencat kushtetuese të tij nuk parashohin aktivizim të nenit 95 për faktin e ruajtjes dhe mbrojtjes së legjitimitetit demokratik. Mbi bazën e kësaj konstatohet se, mungesa e balancimit dhe kontrollit të pushteteve mund të arrihet në rastin kur të dyja institucionet balancohen në kuptim të mos ushtrimit të pushtetit kushtetues, deri në krijimin e institucioneve të reja që dalin nga zgjedhjet e parlamentare të parakohshme.

36. Arsyeja tjetër ka të bëjë me nenin 82 par. 2, i cili përcakton se *“Kuvendi mund të shpërndahet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pas votimit të suksesshëm të mocionit mosbesimit të Qeverisë.”* Kjo nuk përbën dispozitë kushtetuese alternative (të mundësisë) për shpërndarjen e Kuvendit. Kjo dispozitë shpreh rrugën e vetme të mundshme për krijimin e mundësisë për të ruajtur rendin kushtetues, të përcaktuar në nenin 7 të Kushtetutës së Kosovës. Pra dispozita e tillë nuk ka karakter alternativ, por ka karakter të lejimit të mundësisë së vetme për të dhënë zgjidhje kushtetuese në mbrojtje të demokracisë apo legjitimitetit demokratik. Pra, folja modale *“mund”*, e përcaktuar në këtë dispozitë kushtetuese, nuk përbën alternativë në zbatimin e saj, por ofron zgjidhjen e vetme (më adekuate) të mundshme kushtetuese për të vënë në funksion vullnetin e popullit, përmes zgjedhjeve parlamentare në zgjedhjen e përfaqësuesve të ri në institucionet kushtetuese. Mbi bazën këtyre konstatimeve, mund të konkludohet se dekreti i Presidentit është në kundërshtim me nenin 84 par. 4 lidhur me nenin 82 par. 2, si dhe nenet 4 dhe 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
37. Presidenti i Republikës së Kosovës ka nxjerrë dekret me të cilin ka aktivizuar nenin 95, të Kushtetutës, pa asnjë bazë kushtetuese, siç argumentohet më lartë. Ky dekret, në preambulë ka tri anomali kushtetuese. E para, pas mocionit të mosbesimit, përmes dekretit të bazuar në nenin 84 par 4 dhe aktgjykimit 103/2014, aktivizon nenin 95 të Kushtetutës; e dyta, interpreton arbitrarisht nenin 95, kinse partia fituese ka refuzuar të propozojë mandatarin për kryeministër brenda një afati prej 20 ditësh të përcaktuar nga

vetë ai, dhe; e treta, mbi nenin 95 Presidenti ia jep mandatarin për kryeministër partisë së dytë në zgjedhjet e 6 tetorit 2019.

38. Fakti se dekreti i presidentit ka aktivizuar dhe zbatuar nenin 95 përbën shkelje të dyfishtë kushtetuese. Në njërën anë, aktivizon nenin pa u parashikuar në Kushtetutë dhe, në anën tjetër, bën shkelje të llojllojshme kushtetuese brenda aktivizimit kundërkushtetues të nenit 95 të Kushtetutës.

39. *Presidenti nuk mund të zgjedhë rrugën antikushtetuese, kur ka rrugëdalje të qartë kushtetuese.* Edhe sikur Presidenti të vlerësojë se vonesa e partisë të cilës i takon mandatarin mund të krijojë ngërç politik në krijimin e Qeverisë, kjo në asnjë rrethanë nuk lejon Presidentin të ndërmarrë hapa antikushtetues për të dalë nga ajo situatë, vecanërisht duke pasur parasysh faktin se ekziston një veprim kushtetues për të zgjidhur ngërçin, përkatësisht, realizimin e kompetencave të Presidentit sipas Nenit 82 par. 2 të Kushtetutës, me ç'rast shpërndanë Kuvendin dhe shpallë zgjedhjet. Prandaj, edhe nëse Presidenti është i shqetësuar për funksionimin e institucioneve, është i pakuptimtë (së paku juridikisht) insistimi i Presidentit që të vijojë rrugë antikushtetuese me çdo kusht, kur ka përgjegjësinë qartësisht kushtetuese sipas Nenit 82 par. 2. Kjo në vehte tregon arbitraritetin në vendimarrjen e Presidentit.

40. Baza kushtetuese për të aktivizuar nenin 95 sipas nenit 100 dhe nenit 84 par. 4 si dhe aktgjykimin 103/14 të Gjykatës Kushtetuese, i cili ka interpretuar nenin 95 për zgjedhjen e qeverisë pas konstituimit të Kuvendit është në shpërputhje komplet me situatën kushtetuese juridike. Gjasat për të aktivizuar nenin 95 përmes paragrafit 5 pas votimit të mocionit të suksesshëm të qeverisë janë inekzistente. Neni 95 paragrafi 5 i Kushtetutës thekson se *“Nëse Kryeministri jep dorëheqjen ose për arsye të tjera, posti i tij/saj mbetet i lirë, Qeveria bie, dhe Presidenti i Republikës së Kosovës, në konsultim me partitë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, mandaton kandidatin e ri, për të formuar Qeverinë”* Elementet kryesore të cilat e përbejnë tërësinë e nenit 95 par. 5 janë si në vijim:

1) *Nëse Kryeministri jep dorëheqje, ose*

2) *për arsye tjera posti i tij/saj mbetet i lirë, qeveria bie*

3) *Presidenti i Republikës së Kosovës, në konsultim me partitë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, mandaton kandidatin e ri, për të formuar Qeverinë.*

41. Në situatën aktuale kushtetuese, Kryeministri i Republikës së Kosovës nuk ka dhënë dorëheqje. Siç dihet, ndaj qeverisë në tërësi, pa vullnetin e saj, është paraqitur dhe votuar mocioni i mosbesimit. Në këtë rast, neni 100 par. 6 nuk mund ta aktivizojë nenin 95 par. 5, për faktin se kryeministri nuk shpreh vullnetin e vet për të dhënë dorëheqje, për asnjë arsye. Vullneti për të dhënë dorëheqje dhe shkarkimi i qeverisë në tërësi si pasojë e mocionit të mosbesimit në mënyrë të pavullnetshme, nuk janë sinonime në kuptim përmbajtësor kushtetues. Në kuptimin historik, sistematik logjik dhe objektiv të interpretimit të dispozitave kushtetuese konkrete, vërtetohet qartë se këto dispozita kushtetuese prodhojnë situata të ndryshme kushtetuese. Në këtë mënyrë ndahen edhe rrugët zingjyrore të zbatimit të normave kushtetuese.
42. Në lidhje me sa u cek në paragrafin pararendës, në një situatë hipotetike, nëse Kryeministri do të kishte dhënë dorëheqje për arsye të ndryshme, atëherë Presidenti do të kishte qenë i obliguar që në konsultim me partitë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, të mandatojë kandidatin e ri për të formuar Qeverinë. Kësisoj paragrafi 5 i këtij neni dërgon në paragrafin 1 dhe përmbillet me paragrafin 4 të këtij neni. Meqenëse qeveria në tërësi është shkarkuar në mënyrë të pavullnetshme, si pasojë e votimit mocionit mosbesimit, në këtë mënyrë neni 100 par. 6 përfshin dhe e orienton presidentin në zbatim të vetëm të nenit 82 par. 2, të Kushtetutës. Kësisoj nuk ekziston dispozitë kushtetuese në Kushtetutë që i jap mundësi presidentit të aktivizojë nenin 95 par. 5 apo ndonjë paragraf tjetër të këtij neni.
43. Për të vërtetuar edhe më tej konceptin e përmbajtjes së dispozitave të nenit 100 par. 6 dhe 95 par. 5 si dhe ndarjen rrugëve zingjyrore të zbatimit të normave kushtetuese, që rrjedhin nga këto dispozita, jemi të detyruar që serish t'i kthehemi vlerësimit të dispozitave të kornizës kushtetuese lidhur me këtë çështje. Në lidhje me këtë, neni 9.3.8 i Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë përcakton se *“Pas zgjedhjeve, ose në rast se Kryeministri jep dorëheqjen apo nëse vendi i tij mbetet i lirë për arsye të tjera, Kryetari i Kosovës, pas konsultimeve me partitë politike të përfaqësuara në Kuvend, ia propozon Kuvendit një kandidat për Kryeministër. Kandidati i propozuar i paraqet Kuvendit një listë me ministrat e propozuar. Kryeministri bashkë me ministrat zgjidhen nga shumica e deputetëve të Kuvendit.”*⁶ Ndërsa neni 9.3.9 përcakton qartë se *“Në goftë se kandidati i propozuar nuk merr shumicën e kërkuar të votave, atëherë Kryetari i Kosovës propozon brenda dhjetë ditësh një kandidat të ri për Kryeministër. Kandidati i ri, bashkë me listën e ministrave të propozuar nga ai ose ajo, zgjidhet nga shumica e deputetëve të Kuvendit.”*⁷ Siç mund të vërehet, edhe Kushtetuta e Kosovës edhe Korniza Kushtetuese përcaktojnë qartë zingjirin e zbatimi të normave kushtetuese si

⁶ Neni 9.3.8 i Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, është pothuajse identik me nenin 95 par.5, të Kushtetutës së Kosovës.

⁷ Neni 9.3.8 i Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, është pothuajse identik me nenin 95 par. 1,2 dhe 4, të Kushtetutës së Kosovës (përfashtojë afatet).

pasojë e dorëheqjes së Kryeministrit të Kosovës. Të dyja këto akte juridike theksojnë shumë qartë se shkarkimi i Qeverisë së Kosovës si pasojë e mocionit të mosbesimit nuk e aktivizon në asnjë rrethanë nenin 95 par. 5 por nenin 82 par. 2 të Kushtetutës.

44. Elementi i dytë i dispozitës së nenit 95 par. 5, i cili thekson për “arsye tjera posti i tij/saj mbetet i lirë” në interpretimin logjik sistematik dhe objektiv të elementit në fjalë nënkupton vdekjen, ose pamundësia e përhershme që ta ushtrojë funksionin e Kryeministrit, e që dërgon në rënin e qeverisë dhe zbatimin e paragrafëve të nenit 95, siç është theksuar më lartë.
45. Në lidhje me detyrimin kushtetues që “Presidenti i Republikës së Kosovës, në konsultim me partitë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, për të formuar Qeverinë.”⁸ Në këtë aspekt mund të konkludohet se, pas dorëheqjes së kryeministrit apo rënies së qeverisë për arsye të tjera, detyrim kushtetues i presidenti është që të konsultohet me partinë politike ose koalicionin që e ka fituar shumicën në Kuvend për të formuar qeverinë. Në këtë rast, serish zbatohet rruga zingjirore e normave kushtetuese nga paragrafi 1 deri në 4 të nenit 95 të Kushtetutës. Pra, sipas përmbajtjes së këtij neni argumentohet qartë se nenin 95 i Kushtetutës rregullon vetëm dy situata kushtetuese. E para, zgjedhjen e qeverisë pas konstituimit të Kuvendit, dhe zgjedhjen e qeverisë së re, si pasojë e dorëheqjes së kryeministrit dhe si pasojë e mos ushtrimit të pozitës së kryeministrit për shkak vdekjes së tij apo për shkak të pamundësisë së ushtrimit të përhershëm funksionit të kryeministrit. Prandaj situata kushtetuese pas votimit të mosbesimit të qeverisë, aktivizon presidentin në zbatim të nenit 82 par. 2 të Kushtetutës.
46. Presidenti i Republikës së Kosovës, me aktivizimin kundërkushtetues i nenit 95, bën veprim kundërkushtetues edhe brenda kornizave të vetë nenit 95. Kësisoj, edhe nëse aktivizimi i nenit 95 do të kishte bazë kushtetuese në formë të shprehur, përmbajtja e dekretit serish do të konsiderohet në kundërshtim me Kushtetutën. Janë identifikuar tri veprime antikushtetuese të Presidentit të Republikës së Kosovës, në dekretin i tij

⁸ Teksti i nenit 95, par. 5 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës në gjuhën shqipe: “Nëse Kryeministri jep dorëheqjen ose për arsye të tjera, posti i tij/saj mbetet i lirë, Qeveria bie, dhe Presidenti i Republikës së Kosovës, në konsultim me partitë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, mandaton kandidatin e ri, për të formuar Qeverinë [Theksimi ynë].

Teksti i nenit 95, par. 5 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës në gjuhën angleze: “If the Prime Minister resigns or for any other reason the post becomes vacant, the Government ceases and the President of the Republic of Kosovo appoints a new candidate in consultation with the majority party or coalition that has won the majority in the Assembly to establish the Government.” [Theksimi ynë].

Teksti i nenit 95, par. 5 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës në gjuhën serbe: “Ukoliko Premijer da ostavku ili iz nekih drugih razloga njegovu/tjenu mesto ostaje slobodno, Predsednik Republike Kosovo, u konsultaciji sa političkom partijom ili koalicijom koja je dobila većinu u Skupštini, imenuje novog kandidata, za formiranje Vlade.” [Theksimi ynë]. Teksti i Nenit 29, par. 5 i Rregullores së Kuvendit në gjuhën shqipe: “Nëse Kryeministri jep dorëheqje ose për ndonjë arsye tjetër posti i tij mbetet i zbrastë, Qeveria bie. Presidenti i Republikës, me këtë rast, në konsultim me partinë politike ose me koalicionin që e ka fituar shumicën e vendeve të nevojshme në Kuvend për ta formuar Qeverinë, ia propozon Kuvendit kandidatin e ri për kryeministër, i cili e formon Qeverinë.” [Theksimi ynë].

antikushtetues. E para, veprimi parë antikushtetues i Presidentit realizohet pas votimit të mocionit të mosbesimit në Kuvendin e Kosovës, në momentin kur i thërret të gjitha partitë politike në konsultim për formimin e Qeverisë së Kosovës.⁹ Kjo për faktin se pas votimit të suksesshëm të mocionit qeverisë Presidenti i Republikës së Kosovës veç ka aktivizuar dhe njëkohësisht ka zbatuar nenin 95 të Kushtetutës së Kosovës. Së dyti, veprimi antikushtetues i Presidentit ka të bëjë me faktin se ai i ka fituar dhe takuar të gjitha partitë politike parlamentare si pjesëmarrëse në zgjedhjet e 6 tetorit. Kësisoj ai ka bërë shkelje të Kushtetutës nenit 84 par. 14 lidhur me nenin 95 par. 5 lidhur me par. 1 të këtij neni të Kushtetutës. Sepse në nenin 95 par. 1 dhe në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese KO103/14, konkretisht në pjesën e fundit të pikës 84, shprehimisht thuhet *“Gjykata rithekson se Presidenti i Republikës mund të konsultohet vetëm me partinë politike ose me koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, qoftë shumicën absolute, qoftë relative.”* Pas këtij momenti, nga data 2 prill 2020, Presidenti i Kosovës kërkon nga Kryetari i Lëvizjes VETËVENDOSJE! Albin Kurti, që si parti fituese e zgjedhjeve të propozojë kandidatin/en e ri për kryeministër. Lëvizja Vetëvendosje, në letërkëmbimin me Presidentin e Kosovës, **asnjëherë, në asnjë formë, nuk e ka refuzuar propozimin** për të paraqitur kandidatin e ri për kryeministër. Pas letërkëmbimeve në mes Presidentit dhe Kryetarit të Lëvizjes VETËVENDOSJE! për 20 ditë me radhë,¹⁰ Presidenti më 22 prill 2020 dërgon një shkresë kryetarit të Lëvizjes VETËVENDOSJE! z. Albin Kurti në të cilën midis tjerash thuhet, se *“me keqardhje konstatoj se me veprimet tuaja nuk i keni shfrytëzuar të drejtën tuaj të propozimit të kandidatit të ri për të formuar Qeverinë, në pajtim me vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës”*. Në lidhje me këtë situatë kushtetuese, Presidenti i Republikës ka luajtur dy role antikushtetuese. E para, ai, edhe ka kërkuar me shkresë mandatarin për formimin e qeverisë së re, edhe ka refuzuar njëkohësisht pas asnjë bazë kushtetuese propozimin për mandatar për kryeministër, që në bazë të kushtetutës ishte dashur të bënte Lëvizja Vetëvendosje!. Të drejtën kushtetuese për pranim dhe refuzim shprehimisht e ka vetëm partia fituese e zgjedhjeve, Lëvizja Vetëvendosje!. Në këtë rast ai ka luajtur dy role jokushtetuese, atë të uzurpimit të kompetencave kushtetuese të Kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje, për të refuzuar shprehimisht, në formë të shkruar, propozimin për mandatarin, dhe keqpërdorimin e tejkalimin e kompetencave të pozicionit të tij kushtetues. Kujtojmë, se sipas Aktgjykimit Nr. 103/14, pikës 87, të drejtë ekskluzive për të refuzuar mandatin ka vetëm partia që i ka fituar zgjedhjet.¹¹

⁹ Shih Koha Ditore, në <https://www.koha.net/arberi/215661/thaci-sot-nisen-konsultimet-me-partite-politike-per-formimin-e-institucioneve/> (5 prill 2020, 14.00h) dhe Portalin online Kallxo.com, në: <https://kallxo.com/lajm/kriza-politike-thaci-vazhdon-konsultimet-me-partite-tjera-politike/> (5 prill 2020, 14.00h).

¹⁰ Letërkëmbimet nga 2 prilli deri me 21 prill 2020.

¹¹ Shih Aktgjykimin nr.103/14

47. Presidenti i Republikës së Kosovës, në mënyrë kundërkushtetuese, brenda 20 ditëve, pa e refuzuar mandatarin partia që i ka fituar zgjedhjet, ka konstatuar në kundërshtim flagrant me kushtetutën, se partia e fituese me veprimet e saj nuk e ka *“shfrytëzuar të drejtën tuaj të propozimit të kandidatit të ri për të formuar Qeverinë.”* Para së gjithash, duhet të konstatojmë se afati se kur duhet të propozojë partia mandatarin, me kushtetutë nuk është afat i shkruar në asnjë dispozitë kushtetuese apo aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese. Parimisht, qëllimi i mospërcaktimit të afatit për propozim të mandatarit nga partia fituese, në Kushtetutën e Kosovës përcakton të drejtën ekskluzive të partisë fituese që të dërgojë emrin e kandidatit në momentin më të përshtatshëm që ajo vlerëson se janë përmbushur të gjitha kushtet politike administrative dhe teknike për dërgimin e një emri të tillë. Kësisoj, është krejtësisht veprim kundërkushtetues i Presidentit të përcaktojë afat 20 ditor apo çfarëdo afati tjetër në mënyrë arbitrare për dërgimin e emrit të mandatarit, afat që nuk është i përcaktuar në asnjë dispozitë kushtetuese apo ligjore. Parimisht, nuk mund të kërkosh afat nga tjetri përderisa ai afat nuk është i përcaktuar me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi. Afati nuk konsumohet me këmbim të letrave. Letërkëmbimet nuk e konsumojnë afatin. Afatin e konsumon periudha e përcaktuar me dispozita kushtetuese, në rastin konkret dhe asgjë tjetër. Rrjedhimisht, nuk mund të respektohet afati i cili nuk është i paraparë me kushtetutë. Prandaj, ekskluziviteti i dërgimit të emrit mbetet në diskrecionin e partisë fituese, e ky diskrecion është i paafatizuar. Kësisoj, edhe historia e krijimit të institucioneve kushtetuese në vitin 2014 dëshmon qartë se formimi i qeverisë ka zgjatur mbi 6 muaj, vetëm dhe kryekëput si pasojë e mosdërgimit të emrit të mandatarit nga partia fituese te presidenti.
48. *Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk ka përcaktuar afatin se kur duhet të propozojë partia fituese emrin e mandatarit.* Për më tepër, një afat i tillë nuk është i përcaktuar as me ligjet në fuqi e as me ndonjë aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese. Parimisht, qëllimi i mospërcaktimit të afatit për propozim të mandatarit nga partia fituese, në Kushtetutën e Kosovës përcakton të drejtën ekskluzive të partisë fituese që të dërgojë emrin e kandidatit në momentin më të përshtatshëm që ajo vlerëson se janë përmbushur të gjitha kushtet politike, administrative dhe teknike për dërgimin e një emri të tillë. Përkundër kësaj, Presidenti i Republikës së Kosovës, në mënyrë kundërkushtetuese, brenda 20 ditëve, pa e refuzuar mandatarin partia që i ka fituar zgjedhjet, ka konstatuar në kundërshtim flagrant me Kushtetutën, se partia e fituese me veprimet e saj nuk e ka *“shfrytëzuar të drejtën tuaj të propozimit të kandidatit të ri për të formuar Qeverinë.”*
49. *Presidenti i Kosovës nuk ka asnjë të drejtë të caktojë afate kushtetuese në mënyrë arbitrare.* Kësisoj, është krejtësisht veprim kundërkushtetues i Presidentit të përcaktojë afat 20 ditor apo çfarëdo afati tjetër në mënyrë arbitrare për dërgimin e emrit të mandatarit, afat që nuk është i përcaktuar në asnjë dispozitë kushtetuese apo ligjore. Parimisht, nuk mund të kërkosh afat nga tjetri përderisa ai afat nuk është i përcaktuar me

Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi. Për më tepër, afati nuk konsumohet me këmbim të letrave – veçanërisht kur në ato letra, pala në fjalë shprehimisht e cekë faktin se nuk po e refuzon mandatin. Afatin e konsumon periudha e përcaktuar me dispozita kushtetuese, në rastin konkret dhe asgjë tjetër. Rrjedhimisht, nuk mund të respektohet afati i cili nuk është i paraparë me kushtetutë. Prandaj, ekskluziviteti i dërgimit të emrit mbetet në diskrecionin e partisë fituese, e ky diskrecion është i paafatizuar. Kësisoj, edhe historia e krijimit të institucioneve kushtetuese në vitin 2014 dëshmon qartë se formimi i qeverisë ka zgjatur mbi 6 muaj, vetëm dhe kryekëput si pasojë e mosdërgimit të emrit të mandatarit nga partia fituese te presidenti. Mungesa e afateve për propozim në Kushtetutën e Kosovës është në të njëjtën logjikë sikurse me kushtetutat e shteteve evropiane, në të cilat parlamenti e zgjedhë Qeverinë, pavarësisht se a bëhet fjalë për republika apo monarki. Mospërcaktimi i afateve në kushtetuta sa i përket propozimit për të parën herë të kandidatit për kryeministër, është i qëllimshëm, sepse forcat politike nuk mund të detyrohen të lidhin koalicione paszgjedhore lehtësisht, sidomos kur ekzistojnë shpërputhje të mëdha në programet e tyre qeverisëse.

50. *Afattet kushtetuese në raport me formimin e Qeverisë, fillojnë të rrjedhin vetëm në momentin kur presidentit i propozohet një kandidat për kryeministër.* Kjo edhe për faktin se Kreut të Shtetit në një republikë parlamentare, pra edhe në Kosovë, nuk i njihet rol aktiv në jetësimin e vullnetit të tij politik. Kreu i Shtetit ka një rol pasiv në procesin e formimit të Qeverisë. Ai vetëm mandaton kandidatin e propozuar në përputhje me vullnetin e forcave politike. Funkcioni i tij në këtë proces është i njohur në teorinë dhe praktikën kushtetuese si funksion i noterit shtetëror. Prandaj, edhe sikur të zbatohet përshtatshmërisht pas mocionit të mosbesimit neni 95, nuk i takon presidentit që të imponohet në mënyrë kundërkushtetuese duke diktuar edhe përmbajtjen e një kabineti qeveritar.
51. *Presidenti nuk mund të thirret në kompetencën kushtetuese “sigurimi i funksionimit të institucioneve” për të caktuar arbitrarisht afate kushtetuese të cilat nuk i ka caktuar vetë kushtetuta.* Në fakt, duke caktuar arbitrarisht afate kushtetuese për institucionet e tjera, Presidenti po e bën pikërisht të kundërtën, pra po rrezikon funksionimin kushtetues të institucioneve, duke rrezikuar që në krye të vendit të zgjidhet një qeveri me procedura kundërkushtetuese, vendimet e së cilës do të kontestoheshin dhe dëmi, sidomos në kohë të pandemisë, do të ishte enorm. Për më tepër, në kohën kur Kuvendi është funksional dhe me kompetenca të plota dhe nuk ka asnjë dispozitë kushtetuese që kufizon të drejtat e detyrimit e qeverisë në detyrë, nuk ka asnjë arsye që Presidenti të thirret në mosfunksionim të institucioneve. Komentari i Kushtetutës së Republikës së Kosovës sqaron se edhe pse kompetenca e garantimit të funksionimit kushtetues të institucioneve i është mveshur Presidentit, kjo assesi nuk nënkupton që Presidenti i republikës është gardiani më i lartë i kushtetutës apo gardiani më kredibil për mbrojtjen e kushtetutës,

meqë ky është një funksion që kushtetuta ia ka besuar Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, sipas Komentarit, “kushtetuta i jep kompetencën presidentit të republikës për të garantuar funksionimin kushtetues të institucioneve në kuadër të materializimit të kompetencave presidenciale. Për më tepër, i beson atij që këtë detyrë ta kryejë në rastin më të rëndë përmes përdorimit të mjeteve juridike, përkatësisht, duke sfiduar veprime të caktuara përmes parashtrimit të kërkesave në Gjykatën Kushtetuese. Në këtë aspekt, ky paragraf nuk mëton të jep ndonjë kompetencë shtesë për presidentin e republikës, por vetëm të vendos detyrimin që presidenti i republikës ka për të garantuar funksionimin kushtetues të institucioneve në kuadër të kompetencave të tij specifike.” Autorët e komentarit më tej tregojnë se sikurse në rastin aktual, kjo kompetencë ”mund të keqkuptohet ashtu që presidenti i republikës të mund të mbjell praktika të kontrollit të institucioneve tjera shtetërore në bazë të ‘detyrimit’ të tij formal për të garantuar funksionimin kushtetues të institucioneve kushtetuese”, prandaj shtojnë se “materializimi i këtij funksioni nga ana e presidentit të republikës nuk mund të prek në kufijtë e pavarësisë së institucioneve/pushteteve të ndara.” Në fund, komentari sqaron se “është e rëndësishme të ceket që ky paragraf nuk mund të paragjykohet që të ‘imitojë’ rolin e gjykatës kushtetuese, meqë institucioni i presidentit të republikës nuk është mekanizëm me garancione standardesh që të mund të ushtrojë rolin e një gardiani gjyqësor të kushtetutës.” (Komentari i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Enver Hasani & Ivan Cukalovic, f.394-395).

52. *Mungesa e afatit implikon qëllimin që t’i lihet partisë fituese hapësirë për negociim për krijimin e qeverisë.* Përcaktimi i partnerëve, negociimi i programit qeverisës si dhe rrethana të tjera të paparashikuara, janë vetëm disa nga arsyet që duhen të merren parasysh kur flitet për afate kushtetuese për krijimin e qeverisë. Për këtë arsye, Kushtetuta e Kosovës nuk përcakton ndonjë afat brenda të cilit duhet të dërgohet ndonjë emër, sepse sic duket qëllimi i hartuesve ishte pikërisht lënia e hapësirës së mjaftueshme për krijimin e qeverisë përmes procesit politik, pra duke e lënë qëllimshëm të hapur afatin dhe duke mos i dhënë të drejtën asnjë institucioni që ta kufizojë atë. Në një rast të ngjashëm të trajtuar nga Gjykata Kushtetuese në vitin 2014, (Rasti KO 119/14), edhe pse partia fituese kishte vonuar propozimin e emrit për Kryetar Kuvendi për 6 muaj rresht, gjykata megjithatë nuk kishte kufizuar ndonjë afat por thjeshtë kishte konstatuar se e drejta e propozimit të emrit për kryetar kuvendi i takon vetëm partisë së parë të dalë në zgjedhje. Pra edhe pse vonesa në atë rast ishte 6 muaj (për dallim të 20 ditëve në rastin konkret) dhe mosdërgimi i emrit për kryetar kuvendi e kishte bllokuar edhe konstituimin e Kuvendit e edhe krijimin e qeverisë, Gjykata përsëri nuk e afatizoi të drejtën e partisë së parë për të dërguar emrin e kryetarit të kuvendit.

53. *Në rastet kur qëllimi ishte kufizimi i afatit, hartuesit e kushtetutës e kanë bërë këtë në mënyrë shprehimore.* Kjo vërehet nga afati i përcaktuar pas dhënies së emrit për

mandatar, që njëherë është afat 15-ditësh e herën e dytë është afat 10-ditësh. Afate të tjera shprehimore, të përcaktuara në kushtetutë e që kanë të bëjnë me funksionimin e institucioneve përmenden në nenin 66 par. 1 dhe 2, nenin 70 par. 2, nenin 82 par. 1 nënparagrafët 1 dhe 3, nenin 86 par. 2 dhe 6, nenin 95 par. 2 dhe 4, nenin 100 par. 3 dhe 5, nenin 113 par. 5, nenin 131 par. 5 dhe 6, nenin 145 par. 1 dhe 2, nenin 161 par. Kjo qartazi tregon se në rastet kur qëllimi i hartuesve të Kushtetutës është kufizimi i afateve, ata e kanë bërë këtë në mënyrë shprehimore.

54. Mungesa e afateve për propozim në Kushtetutën e Kosovës është në të njëjtën logjikë sikurse me kushtetutat e shteteve evropiane në të cilat parlamenti e zgjedhë Qeverinë, pavarësisht se a bëhet fjalë për republika apo monarki. Mospërcaktimi i afateve në kushtetuta sa i përket propozimit për të parën herë të kandidatit për kryeministër, është i qëllimshëm, sepse forcat politike nuk mund të detyrohen të lidhin koalicione paszgjedhore, edhe sikur të ekzistonin shpërputhje të mëdha në programet e tyre qeverisëse.
55. Afatet kushtetuese në raport me formimin e Qeverisë, fillojnë të rrjedhin vetëm në momentin kur presidentit i propozohet një kandidat për kryeministër. Kjo edhe për faktin se Kreut të Shtetit në një republikë parlamentare, pra edhe në Kosovë, nuk i njihet rol aktiv në jetësimin e vullnetit të tij politik. Kreu i Shtetit ka një rol pasiv në procesin e formimit të Qeverisë. Ai vetëm mandaton kandidatin e propozuar në përputhje me vullnetin e forcave politike. Funkzioni i tij në këtë proces është i njohur në teorinë dhe praktikën kushtetuese si funksion i noterit shtetëror. Prandaj edhe sikur të zbatohet përshtatshmërisht pas mocionit të mosbesimit neni 95, nuk i takon presidentit që të imponohet në mënyrë kundërkushtetuese duke diktuar edhe përmbajtjen e një kabineti qeveritar.
56. *Presidenti nuk është 'kushtetutbërës', pra nuk shkruan kushtetutë.* Procedura për amandamentimin e Kushtetutës së Kosovës, përfshirë këtu ndryshimin apo plotësimin e saj, përcaktohet shumë qartë në Nenin 144 të Kushtetutës. Dhe, bazuar në këtë, kompetenca e kushtetutbërjes i takon ekskluzivisht Kuvendit të Kosovës, ndërkaq e drejta e interpretimit kushtetues i takon Gjykatës Kushtetuese. Presidenti ka mundësinë e vetme që të jetë propozues i ndryshimeve të Kushtetutës duke ia dërguar ato Kuvendit, por në asnjë rrethanë, atij nuk i është besuar e drejta që të jetë kushtetutbërës, në rastin konkret, duke krijuar afate artificiale dhe arbitrare. E edhe kjo Gjykatë e nderuar, ka kompetencë të interpretojë vetëm atë tekst që veç ekziston në Kushtetutë, por në asnjë rrethanë nuk mund të zë vendin e kushtetutbërësit dhe të krijojë norma të reja, përfshirë këtu edhe afatin në fjalë, sepse kjo nuk do të ishte interpretim por kushtetutbërje.
57. Po ashtu, duhet theksuar se refuzimi i shfrytëzimit të një të drejte bëhet në mënyrë shprehimore. Pra, bartësi i asaj të drejte duhet që shprehimisht të heq dorë nga shfrytëzimi

i saj. Me theks të veçantë, kriteri që heqja dorë të bëhet në mënyrë shprehimore, shfaqet në procesin e formimit të institucioneve kushtetuese, sepse ka raste kur fituesi i zgjedhjeve e njofton presidentin se nuk dëshiron të shfrytëzojë të drejtën e tij për të propozuar një kandidat për kryeministër. Edhe praktika kushtetuese në Kosovë e njeh një rast të tillë. Refuzimin e z. Veseli që në vitin 2019 të propozojë një kandidat të ri për Kryeministër pas dorëheqjes së z. Haradinaj. Mirëpo, as në këtë rast, ndonëse bëhej fjalë për dorëheqje dhe jo mocion të mosbesimit, presidenti nuk procedoi tutje me përmbushjen e detyrimit të tij kushtetues për të garantuar formimin e një Qeverie të re me forcat politike.

58. *Refuzimi i shfrytëzimit të një të drejte, në këtë rast të drejtës për të dërguar emrin e mandatarit, bëhet në mënyrë shprehimore.* Pra, bartësi i asaj të drejte duhet që shprehimisht të heq dorë nga shfrytëzimi i saj. Me theks të veçantë, kriteri që heqja dorë të bëhet në mënyrë shprehimore, shfaqet në procesin e formimit të institucioneve kushtetuese, sepse ka raste kur fituesi i zgjedhjeve e njofton presidentin se nuk dëshiron të shfrytëzojë të drejtën e tij për të propozuar një kandidat për kryeministër. Edhe praktika kushtetuese në Kosovë e njeh një rast të tillë. Refuzimin e z. Veseli që në vitin 2019 të propozojë një kandidat të ri për Kryeministër pas dorëheqjes së z. Haradinaj. Mirëpo, as në këtë rast, ndonëse bëhej fjalë për dorëheqje dhe jo mocion të mosbesimit, presidenti nuk procedoi tutje me përmbushjen e detyrimit të tij kushtetues për të garantuar formimin e një Qeverie të re me forcat politike. Për më tepër, edhe vetë aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese flet qartë për mundësinë e partisë për të refuzuar dërgimin e emrit për mandatar (Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese KO 103/14, paragrafi 87). Në rastin konkret, refuzimi nuk është bërë as në mënyrë eksplicite e as implicate. Përkundrazi, partia fituese e ka njoftuar Presidentin se NUK E REFUZON këtë të drejtë dhe se do të shfrytëzojë këtë të drejtë sa më parë që të jetë e mundur. (Shih letërkëmbimin e bashkëngjitur).
59. Kësisoj, dekreti i Presidentit me të cilin i është dhënë mandati partisë së dytë sipas nenit 95 par. 4, edhe pse nuk është përcaktuar në dekret, e që në fakt nuk është respektuar) neni 95 par. 1 dhe 2, përbën shkelje kushtetuese të nenit 95, nenit 84 par. 14, neni 82 par. 2 dhe aktgjykimit nr. 103/14 të Gjykatës Kushtetuese. Partia apo koalicioni që nuk i ka fituar zgjedhjet nuk mund të krijojë qeveri të re pa respektuar procedurat kushtetuese, të cilat në asnjë formë nuk e anashkalojnë partinë fituese të zgjedhjeve. Prandaj, dekreti është kundërkushtetues dhe cenon normat kushtetuese të përcaktuara në përmbajtjen e kësaj kërkesë.
60. Përveç shkeljeve kushtetuese në aktivizim të nenit 95 dhe brenda kornizës së nenit 95 të Kushtetutës, konsiderojmë se çdo dhënie e mandatit partisë së dytë, edhe nëse dekreti i Presidentit do të supozohet se kishte bazë kushtetuese, deri në zbatim të nenit 95.4 të kushtetutës, do të ishte veprim kundërkushtetues krijimi i qeverisë së re pa partinë

fituese. Në këtë mënyrë do të ndryshohet legjitimiteti demokratik; do të shkelej vullneti i qytetarëve përmes krijimit të konjukturave artificiale partiake për të krijuar qeverinë në kundërshtim me legjitimitetin demokratik respektivisht me zërin e popullit; do të humbte kuptimi i garës demokratike për fitimin e zgjedhjeve parlamentare; do mundësohej që rënia dhe krijimi i qeverisë së re përmes krijimit të konjunkturave parlamentare partiake të ishte shumë e zakonshme (shpeshtë); do të çrregullohej funksionimi i gjithë aparatit shtetëror nën menaxhimin dhe kontrollin e pushtetit ekzekutiv, si pasojë alternimit të shpeshtë të partive politike në pjesëmarrje të pushtetit ekzekutiv. Në këtë mënyrë do të përmbysej rendi kushtetues i Republikës së Kosovës.

61. Kësisoj, dekreti i Presidentit me të cilin i është dhënë mandati partisë së dytë sipas nenit 95 (e qw do tw ishte dashur tw pwrçaktohet nw dekret sipas nenit 95.4, edhe nëse do të kishte respektuar (e që në fakt nuk është respektuar) neni 95 par. 1 dhe 2, përbën shkelje kushtetuese të nenit 95, nenit 84 par. 14, neni 82 par. 2 dhe aktgjykimit nr. 103/14 të Gjykatës Kushtetuese. Partia apo koalicioni që nuk i ka fituar zgjedhjet nuk mund të krijojë qeveri të re pa respektuar procedurat kushtetuese, të cilat në asnjë formë nuk e anashkalojnë partinë fituese të zgjedhjeve. Prandaj, dekreti është kundërkushtetues dhe cenon normat kushtetuese të përcaktuar në përmbajtjen e kësaj kërkesë.
62. Përveç shkeljeve kushtetuese në aktivizim të nenit 95 dhe brenda kornizës së nenit 95 të Kushtetutës, konsiderojmë se çdo dhënie e mandatit partisë së dytë, edhe nëse dekreti i Presidentit do të supozohej se kishte bazë kushtetuese, deri në zbatim të nenit 95 par. 4 të kushtetutës, do të ishte veprim kundërkushtetues krijimi i qeverisë së re pa partinë fituese. Në këtë mënyrë do të ndryshohet legjitimiteti demokratik; do të shkelej vullneti i qytetarëve përmes krijimit të konjunkturave artificiale partiake për të krijuar qeverinë në kundërshtim me legjitimitetin demokratik, respektivisht me zërin e popullit; do të humbte kuptimi i garës demokratike për fitimin e zgjedhjeve parlamentare; do mundësohej që rënia dhe krijimi i qeverisë së re përmes krijimit të konjunkturave parlamentare partiake të ishte shumë e zakonshme (shpeshtë); do të çrregullohej funksionimi i gjithë aparatit shtetëror nën menaxhimin dhe kontrollin e pushtetit ekzekutiv si pasojë alternimit të shpeshtë të partive politike në pjesëmarrje të pushtetit ekzekutiv. Në këtë mënyrë do të përmbysej rendi kushtetues i Republikës së Kosovës.

KËRKESË për VENDOSJEN e MASËS së PËRKOHSHME ndaj Dekretit të Presidentit të Republikës së Kosovës Nr. 24/2020 të datës 30 prill 2020.

63. Në bazë të nenit 27 të Ligjit, Gjykata sipas detyrës zyrtare, po me kërkesë të palës në procedurë, mund të vendosë masa të përkohshme ndaj çështjes që është objekt shqyrtimi në procedurë, me qëllim të evitimit të (1) rreziqeve apo (2) dëmeve të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave (3) është në interesin publik. Paragrafi i dytë i këtij neni përcakton e kohëzgjatja e këtyre masave duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale.
64. Gjykata duke u bazuar në rregulloren e saj ka vendosur masa të përkohshme edhe në rastet kur ka konsideruar se (1) kërkesa është *prima facie* e pranueshme, (2) do t'i shkaktonte dëm të pariparueshëm palës apo (3) është në interesin publik.
65. Në këtë kuptim, masa e përkohshme (3) është në interesin publik, sepse një veprim i Kuvendit bazuar në dekretin kundërkushtetues të Presidentit (2) do t'i shkaktonte dëm të pariparueshëm palës, ngase: a) Qeveria që do të votohej bazuar në këtë dekret do të merrte vendime që prekin interesin publik të cilat pastaj do të shpallehin nule nëse vetë dekreti është jokushtetues; b) Qeveria do të duhej të shfrytëzonte resurset publike/buxhetin, shfrytëzim ky që do të ishte i kundërligjshëm; c) Qeveria do të mund të ndërmernte veprime dhe masa që prekin të drejtat kushtetuese të qytetarëve, shkak të pandemisë; d) Nëse me skenarin që votohet qeveria bazuar në këtë dekret nr. 24/2020 dhe pas një-dy apo tre muajsh p.sh shpallet jokushtetuese zgjedhja e Qeverisë, nga ai moment ajo qeveri duhet të ndërprejë çdo veprimtari. Në atë situatë, asnjë Qeveri nuk do të ishte në detyrë, e Kosova nuk mund të ngelë deri në zgjedhje të reja edhe pa Qeveri kujdestare, prandaj është e domosdoshme që para votimit të Qeverisë, të dihet përputhshmëria me Kushtetutën e asaj procedure.
66. Për të vlerësuar këtë kërkesë për vendosjen e masës së përkohshme, konsiderojmë se kanë relevancë procedurat e zhvilluara sipas një kërkesë të ngjashme të dorëzuar nga deputetët e Kuvendit të Kosovës (pavarësisht se në atë procedurë kontestohet një vendim i Kuvendit dhe jo dekret i Presidentit), por edhe ai rast, sikurse ky që është në shqyrtim para Gjykatës, ka të bëjnë me procesin e legjitimitetit të institucioneve kushtetuese. Gjykata në rastet kur deputetët e Kuvendit kanë parashtruar kërkesa për vlerësim të

kushtetutshmërisë së një veprimi apo vendimi të autoriteteve publike, për të cilat janë palë e autorizuar para Gjykatës, kjo e fundit ka konstatuar që kërkesa konsiderohet si *prima facie* e pranueshme, duhet të jetë e dorëzuar nga numri i nevojshëm i deputetëve nënshkrues të kërkesës dhe që ajo të jetë dorëzuar brenda afatit të përcaktuar me Ligj (shih Vendimin për masë të përkohshme në rastin Nr. KO 119/14, paragrafi 30).

67. Për më tepër, vendimet që mund të merren nga ana e një Qeverie të zgjedhur në mënyrë kundër kushtetuese do të duhej të shpallehin nulë. Duke ditur kompetencat ekzekutive të Qeverisë, këto vendime do të mund të lidheshin me çështje të sigurisë nacionale, me liritë dhe të drejtat e njeriut, me buxhetin e Republikës së Kosovës, e shumë çështje të tjera të cilat pastaj do të duhej të ktheheshin prapa dhe do të dëmtonin në masë të madhe interesin publik.
68. Implikimi ekonomik: Masat aktuale rreth pandemisë janë në fuqi deri me 4 maj dhe pas kësaj date do të ketë nevojë për vendime të reja, të cilat do të kenë implikime të mëdha financiare e ekonomike. Si rrjedhojë, nëse zgjedhje e qeverisë do të rezultonte në kundërshtim me kushtetutën, atëherë të gjitha vendimet e qeverisë të karakterit ekonomik do të preknin në mënyrë direkte sistemin bankar, qarkullimin ekonomik të parasë e të mallrave, të drejtat e bizneseve private dhe funksionimin normal të ndërmarrjeve publike.
69. Implikimet ndërkombëtare: Një qeveri e zgjedhur do të mund të hynte në obligime ndërkombëtare, qofshin ato financiare apo të natyrës tjetër të karakterit bilateral ose multilateral. Të gjitha këto pastaj do të duhej të ktheheshin në pikën zero nëse do të konstatohej një shkelje kushtetuese gjatë zgjedhjes së qeverisë.
70. Dëmtimi i interesit publik është shumë më i madh nëse del që Qeveria e zgjedhur është kundërkushtetuese se sa nëse vazhdon (deri në vendimin e gjykatës) një qeveri në detyrë e cila është zgjedhur në përputhje me Kushtetutën dhe kryen detyrën (si qeveri në detyrë) pa kufizime të mëdha, meqë nuk ka as dispozitë kushtetuese e as vendim të gjykatës kushtetuese që ka kufizuar kompetencat e një qeverie që është shkarkuar si rezultat i një mocioni mosbesimi.
71. Në një rast hipotetik, nëse qeveria e re, bazuar në dekretin e Presidentit zgjidhet nesër, por pas dy muajsh konsiderohet që kjo zgjedhje ishte jokushtetuese, atëherë ajo qeveri nuk do të mund të kryente më detyrën as edhe për një ditë të vetme, sepse vendimi i Gjykatës gjithçka do të kthente në pikën zero, pra për shkak të pavlefshmërisë absolute të një vendimi të tillë. Në atë situatë, as Qeveria e zgjedhur në mënyrë kundërkushtetuese nuk do të mund të kryente detyrën, e as qeveria paraprake e cila e ka dorëzuar detyrën nuk do të mund të kthehej. Pra për herë të parë në histori të vendit, Kosova do të mbetej pa qeveri fare deri në një vendim tjetër apo zgjedhje të reja. Dëmi që do t'i bëhej vendit

dhe interesit publik, sidomos në kohë pandemie, nga mungesa e tërësishtme e një qeverie, do të ishte enorm.

72. Masa e përkohshme është dhënë edhe në raste kur rreziku për dëm ndaj interesit publik ka qenë shumë më i vogël, psh kur është pezulluar vendimi për zgjedhje të kryetarit të Kuvendit në vitin 2014 për rastin KO119/14¹², ku edhe pse Kryetari i Kuvendit nuk e ka asnjë kompetencë ekzekutive, në krahasim me kryeministrin dhe qeverinë. Kryetari i kuvendit ka kompetencë formale të drejtimit të seancave dhe ka të drejtën e votës si deputet, e cila ka peshë të barabartë me votën e deputetëve të tjerë, dhe e drejtë kjo që nuk e humbet edhe nëse nuk është kryetar kuvendi.
73. Duke marrë parasysh se kërkesa është dorëzuar sipas nenit 113 paragrafi 2 (1) i Kushtetutës dhe nenet 29 dhe 30 të Ligjit, kërkohet që kërkesa të jetë nënshkruar nga 30 deputetë dhe që e njëjta të jetë dorëzuar në Gjykatë brenda afatit gjashtë (6) mujor pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar. Parashtruesit e kërkesës janë 30 deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe kërkesën kundër aktit të kontestuar e kanë dorëzuar brenda afatit të përcaktuar me ligj. Dekreti i Presidentit ka hyrë në fuqi me datën 30 prill 2020 ndërsa parashtruesit e kanë dorëzuar kërkesën më datën 30 prill 2020/të njëjtën ditë.
74. Prandaj parashtruesit kanë plotësuar kriterin e përcaktuar nga dispozitat kushtetuese dhe ligjore të cilat janë materializuar përmes vendimeve të Gjykatës që kërkesa e tyre të konsiderohet si *prima facie* e pranueshme dhe Gjykata të vendosë masat e përkohshme.
75. Kësisoj duke i marrë parasysh argumentet e paraqitura në përmbajtjen e kësaj kërkesë si dhe në bazë të nenit 27 par. 1 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, lidhur me rregullin 55 par. 1 të Rregullores së Kuvendit, kërkohet nga Gjykata Kushtetuese që të merr vendim për vendosjen Masës së Përkohshme për shkak se dekreti i Presidentit nr. 24/2020i datës 30 prill 2020. cenon nenin 84 par. 4 dhe 14, nenin 82 par. 2, nenet 4 dhe 7, si dhe nenin 95 të Kushtetutës së Kosovës. Pra çdo zbatim i këtij dekreti do të dëmtonte skajshmërisht legjitimitetin demokratik, do të çrregullonte mënyrën e funksionimit demokratik të institucioneve kushtetuese, do të cenohej ndarja pushteteve, kontrolli dhe balancimi në mes tyre, duke e vënë Kuvendin në pozitën si organ i cili do të shndërrohej në funksion të

¹² Në rastin KO119/14, më 23 korrik 2014, Gjykata Kushtetuese ka nxjerrë masë të përkohshme në lidhje me zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit. Gjykata Kushtetuese ka marrë vendim për miratimin e masës së përkohshme, duke e ditur se pozicioni i Kryetarit të Kuvendit dhe kompetencat kushtetuese që ai ushtron janë pakrahasshmërisht më të parëndësishme se sa kompetencat kushtetuese të Qeverisë. Gjykata Kushtetuese e miraton masën e përkohshme me arsyetimin se parashtruesit e Kërkesës kanë paraqitur argumente të mjaftueshme bindëse, sepse parashtruesi ka konsideruar se, siç evidenton Gjykata, mosmarrja e masës së përkohshme mund të shkaktojë një dëm të pakthyeshëm në funksionimin e institucioneve të Republikës së Kosovës, si dhe demokracinë në Republikën e Kosovës. Nisur nga kjo, në rastin e mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë dhe tentimit të zgjedhjes së Qeverisë, dëmi i shkaktuar nga mosmiratimi i masës së përkohshme do të ishte shumëfish më i madh se sa dëmi në rastin KO119/14.

realizimit të interesave grupore parlamentare, si dhe do të cenoheshin vlerat themelore mbi të cilat qëndron rendi kushtetues i Republikës së Kosovës.

76. Prandaj, zbatimi i këtij dekreti do të prodhonte dëme të pariparueshme për demokracinë në përgjithësi si burim prej të cilit krijohen dhe funksionojnë institucionet kushtetuese, duke prishur dhe dëmtuar vlerat mbi të cilin qëndron rendi kushtetues.

Kërkesë për Seancë Dëgjimore Publike

77. Në përputhje me Rregullin 42 të Rregullores së Gjykatës Kushtetuese, deputetët nënshkrues kërkojnë me respekt nga Gjykata që të vendosë për mbajtjen e seancës dëgjimore lidhur me kontestimin e DERKETT nr. 24/2020 të datës 30.04.2020 të Presidentit të Republikës së Kosovës.

78. Parashtruesit e kësaj kërkesë vlerësojnë se është në interes publik që të mbahet kjo seancë dëgjimore publike, për shkak se përmbajtja e këtij dekreti shkel rendin kushtetues, si dhe disa dispozita kushtetuese thelbësore që hapin rrugën kushtetuese të krijimit të legjitimitetit të ri përmes zgjedhjeve parlamentare të parakohshme.

Dokumentacioni dhe Informatat Përcjellëse

Dokumentet e bashkëlidhura me kërkesën e parashtruar nga deputetët nënshkrues, janë në këtë përmbajtje:

1. Dekreti
2. Listën e nënshkrimeve të deputetëve që mbështesin kërkesën.
3. Letrat e Presidentit të Republikës drejtuar Kryetarit të Lëvizjes VETËVENDOSJE!
4. Letrat e Kryetarit të Lëvizjes VETËVENDOSJE! dhe Kryeministrit në detyrë të Republikës së Kosovës drejtuar Presidentit të Republikës.
5. Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mbi certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të 6 tetorit 2019.

Pasqyra e Zgjidhjes së Kërkuar

Sipas pretendimeve të shprehura në përmbajtjen e kësaj kërkesë, deputetët nënshkrues, duke u mbështetur në dispozitat e Nenit 113,2 (1) të Kushtetutës së Kosovës, si dhe rregullën 59 par. 1 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese, kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese që sipas kompetencave kushtetuese dhe ligjore të nxjerrë këtë:

A K T G J Y K I M

Me të cilin vendos

- I. Të shpallë të PRANUESHME këtë kërkesë.
- II. Të vendosë menjëherë MASËN E PËRKOHSHME mbi Dekretin në mënyrë që të parandalohen dëmet e pariparueshme për palën dhe institucionin, si dhe është në interesin publik.
- III. Të shpallë Dekretin e Presidentit nr. 24/2020, datë 30 prill 2020, NË KUNDËRSHTIM MË KUSHTETUTËN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS;
- IV. Të Urdhërojë që ky aktgjykim t'u komunikohet palëve dhe në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, të shpallet në Gazetën Zyrtare.
- V. Ky aktgjykim të hyjë në fuqi menjëherë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

27 -11- 2019

Prishtinë / Pristina

Nr./Bf. 1845-2019

Në pajtim me autorizim e dhëna nenin 106.1, 106.3 dhe 106.4 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 27.11.2019, nxjerrë këtë:

VENDIM

Për Certifikimin e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Kosovës të 06 Tetorit 2019

- I. Pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotim dhe në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, si dhe kur të gjitha apelimet e bëra që u përkasin votimit dhe numërimit, janë vendosur nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (PZAP) dhe nga Gjykata Supreme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të datës 06 tetor 2019.
- II. Rezultatet e zgjedhjeve si në pikën I i janë bashkangjitur këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
- III. Këto rezultate janë përfundimtare dhe detyruese.
- IV. Obligohet Sekretariati, që rezultatet e certifikuara përfundimtare të zgjedhjeve t'i publikojë në formë tabelare në pajtim me këtë vendim.
- V. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 27.11.2019

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve





REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PRESEDNIK

Nr. i Dekretit: 24 /2020

Presidenti i Republikës së Kosovës,
në mbështetje të nenit 84 (pikat 4 dhe 14) dhe nenit 95 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,
nenit 6 të Ligjit Nr. 03/L – 094 për Presidentin e Republikës së Kosovës (GZ, Nr. 47, 25 janar
2009), duke marrë parasysh Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në Rastin KO 103/14, (1 korrik
2014), si dhe në rrjedhë të propozimit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, të pranuar nga Zyra e
Presidentit më 30.04.2020 (Nr. Prot.: 409), nxjerr:

D E K R E T

1. Z. Avdullah Hoti, i propozohet Kuvendit të Republikës së Kosovës kandidat për Kryeministër për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës.
2. Kandidati nga pika 1 e këtij Dekreti, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas emërimit, paraqet përbërjen e Qeverisë para Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe kërkon miratimin nga ana e Kuvendit.
3. Dekreti hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

Hashim Thaçi

President i Republikës së Kosovës

Prishtinë; 30.04.2020

Dekreti t'i dërgohet:

- Z. Avdullah Hoti, kandidat për Kryeministër për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës;
- Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- a/a.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Date: 01.04.2020

Ref: 108/2020

I nderuar President i Republikës së Kosovës,

Me shumë kënaqësi do të takohem me ju për të folur për hapat e mëtejshme sipas Kushtetutës, pas mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë. Po ashtu, konsideroj se zotimi juaj se do t'i ndërmerrni këta hapa, është shenjë pozitive për Republikën tonë. Shpresoj shumë se, gjatë ditëve në vijim, do t'i qëndroni besnik këtij zotimi. Si kurrë më parë, Republika e Kosovës ka nevojë për një president që e respekton Kushtetutën, deri në çdo pikë e presje të saj.

Në këtë drejtim, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si dhe vetë praktika juaj e mëparshme në vitin 2017, e bëjnë të qartë se, pas mocionit të suksesshëm të mosbesimit, e vetmja rrugë përpara është shpërndarja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 82.2 të Kushtetutës, dhe shpallja e zgjedhjeve të parakohshme.

Prandaj, dëshiroj paraprakisht t'ju bëj të qartë, se çështja e vetme për të cilën do të bisedoj sot me ju, është se kur do të jetë koha më e përshtatshme për shpërndarjen e Kuvendit, duke marrë parasysh në veçanti gjendjen emergjente të shëndetit publik më të cilën po përballlet Republika e Kosovës në këtë kohë. Kjo është një çështje që duhet të diskutojmë sa më shpejtë që të jetë e mundur, si dhe një çështje për të cilën jemi të detyruar për t'i mbajtur qytetarët e Republikës, burimin e sovranitetit demokratik, vazhdimisht të informuar.

Ndërsa, për sa i përket interpretimeve të gabuara të nenit 95.5 të Kushtetutës, këtë temë të rëndësishme dytësore apo tretësore, mund ta lëmë për ndonjë ditë tjetër.

Me respekt,

Albin Kurti
 Kryeministër në detyrë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Datë: 01.04.2020

Ref: 109/2020

I nderuar President i Republikës së Kosovës,

Më vjen mirë që u takuam sot.

Dëshiroj t'ju falenderoj për qëndrimin tuaj të ritheksuar disa herë gjatë takimit, në lidhje me gatishmërinë për respektimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe praktikës kushtetuese.

Në lidhje me njoftimin tuaj se jeni duke kryer "konsultime" me liderët e partive të tjera politike, nuk kam as kompetencën, as dëshirën që t'ju udhëzoj se si e organizoni agjendën tuaj ditore. Mirëpo, dëshiroj të potencoj qëndrimin tim se konsultime të tilla nuk kanë bazë në asnjë dispozitë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Po ashtu, dëshiroj të ritheksoj gatishmërinë time që të rrimë në kontakt lidhur me betejën tonë kundër virusit COVID-19, si dhe me detyrën tuaj për të shpërndarë Kuvendin e Republikës së Kosovës pas mocionit të mosbesimit. Ndërsa, për çdo çështje tjetër jashtë këtyre dy temave, e ripërsëris qëndrimin tim të shprehur në takimin e sotëm, që komunikimi ndër-institucional mes Zyrës së Presidentit dhe Zyrës së Kryeministrit, të vazhdojë në formën e shkruar.

Me respekt,

Albin Kurti

Kryeministër në detyrë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Datë: 13.04.2020

Ref: 120/2020

I nderuar President i Republikës së Kosovës,

Në shkresën tuaj të datës 01.04.2020, si dhe gjatë takimit tonë ndërinstitucional të së njëjtës datë, ju keni theksuar, ritheksuar dhe stërtheksuar vullnetin tuaj për të respektuar në tërësi Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës. Prandaj, më lejoni që t'ju shpreh keqardhjen time të thellë pas shkresave tuaja të fundit, në të cilat ju e deklaroni haptas qëllimin për të anashkaluar detyrën tuaj kushtetuese që të shpërndani Kuvendin dhe të shpallni zgjedhje të reja, pas përfundimit të betejës kundër COVID-19.

Ndonëse në dy shkresat tuaja të fundit, atë të datës 02.04.2020 dhe atë të datës 10.04.2020, thirrreni në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastin KO 103/14 i datës 30.06.2014 (i publikuar më 01.07.2014), veprimet tuaja të cilat qartazi janë në kundërshtim me nenet e Kushtetutës të cilëve ju referoheni dhe Aktgjykimin të cilin ju përmendi, tregojnë se Ju dhe stafi juaj nuk i keni lexuar mjaftueshëm dhe me kujdes të njëjtat.

Në shkresën tuaj të datës 10.04.2020 theksoni se keni zhvilluar takime konsultative me përfaqësuesit e të gjitha partive politike të përfaqësuara në Kuvend me qëllim të vlerësimit të interesit të partive politike në raport me zgjedhjet e reja apo formimin e Qeverisë së re. Më lejoni të ju rikujtoj se nuk është në kompetencën e Presidentit të Republikës së Kosovës vlerësimi i interesave të partive politike, por mbrojtja e interesit shtetëror. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese në paragrafin 84 të Aktgjyimit të saj në rastin KO 103/14 shprehimisht ka konstatuar se "Gjykata rithekson se Presidenti i Republikës mund të konsultohet **vetëm me partinë politike ose me koalicionin** që ka fituar shumicën në Kuvend, qoftë shumicë absolute, qoftë relative." Prandaj duke zhvilluar takime të tilla konsultative, Ju keni vepruar në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, sepse aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese janë akte juridike përmes të cilave realizohet kushtetutshmëria dhe konsiderohen burim i të Drejtës Kushtetuese. Për të qenë edhe më i qartë, siç e dini, para takimit dhe pas takimit me Ju, jeni njoftuar zyrtarisht nga unë se takimet me ju po i zhvilloj në cilësinë e Kryeministrit në detyrë dhe kam qenë i shoqëruar nga dy

këshilltarët e mi të jashtëm të cilët nuk janë anëtarë të Lëvizjes VETËVENDOSJE!. Kam qenë në takim që për temë diskutimi ka pasur gjendjen e emergjencës shëndetësore dhe çështjen e shpalljes së zgjedhjeve pas mocionit të mosbesimit.

Po ashtu, më lejoni të ju rikujtoj se pas mocionit të suksesshëm të mosbesimit, përmes të cilit është shkarkuar Qeveria e Republikës së Kosovës, presidentit nuk i krijohet hapësirë që të luaj rolin e një akteri politik duke tentuar të imponojë vullnetin e tij në jetën politike. Presidentit të Republikës së Kosovës, si organ kushtetues, një mocion mosbesimi i jep të drejtën që të përmbushë vetëm një veprim të përcaktuar nga kushtetutëdhënësi. Pra, shpërndarjen e Kuvendit në përputhje me nenin 82.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Se kjo është procedura e vetme të cilën e parashihet Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk është vënë asnjëherë në dyshim as në praktikën e deritanishme kushtetuese. Se nuk ka pasur asnjëherë takime konsultative me partinë politike që ka fituar shumicën në Kuvend është fakt notor. Se presidenca çdoherë e ka konsideruar të domosdoshme shpalljen e menjëhershme të zgjedhjeve, përpos që vërtetohet me faktin se në vitin 2010¹ dhe 2017² është shpërndarë Kuvendi dhe janë shpallur zgjedhjet në po të njëjtën ditë kur mocioni i mosbesimit është votuar në Kuvend, po ashtu vërtetohet nga intervista e U.D Presidentit z. Jakup Krasniqi i cili në datën 02.11.2010 pati theksuar se *"Ndoshta është mirë të sqarohet se ky mocion ndodh sipas pikës kushtetuese ku flitet për Kuvendin dhe në fund të këtij kapitulli, në Nenin 82 parashihet se nëse mocioni i mosbesimit mbështetet nga 61 deputetë, atëherë nuk ka më procedura të tjera në Kuvend. E vetmja procedurë mbetet shpërndarja e Kuvendit dhe caktimi i datës për zgjedhje. Edhe kjo bëhet sipas kohës më së paku 30 ditë, e më së shumti 45 ditë pas shpërndarjes së Kuvendit."* Duke vazhduar se *"Me Kushtetutë është paraparë që pasi të kalojë mocioni, kam të drejtë që deri në dhjetë ditë të shpërndaj Kuvendin dhe pastaj ta dekretoj datën e zgjedhjeve. Por ndoshta këtu duhet të ketë procedura më të shpejta për shkak se koha na obligon që të kemi procedura më të shpejta. Sido që të jetë, ne do të veprojmë gjithmonë duke u bazuar në normat e parapara me Kushtetutë."*³

Në fakt, se zgjedhjet janë opsioni i vetëm pas një mocioni të suksesshëm të mosbesimit është theksuar edhe nga Ju në vitin 2010, në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës të datës 02.11.2010, kur keni kërkuar votat pro mocionit të mosbesimit keni theksuar se *"Sot besoj se do të votoni drejt duke i vënë fund krizës institucionale e politike e pastaj të dilni para qytetarëve në zgjedhje të reja për të rimarrë besimin e tyre. Duke e bërë një veprim të tillë, i cili është plotësisht në përputhje me kushtetutën tonë, ju i hapni rrugë krijimit të institucioneve të reja më të fuqishme të shtetit tonë me një legjitimitet të ri."*⁴

Pikërisht me faktin se një mocion mosbesimi detyron presidentin që t'i shpallë zgjedhjet, AAK në atë kohë pati refuzuar që të merr pjesë në votimin e mocionit nën arsyetimin se *"Sipas kësaj partie*

¹ Dekret i U.D. Presidentit të Republikës së Kosovës z. Jakup Krasniqi i datës 02.11.2010.

² Dekret i Presidentit të Republikës së Kosovës z. Hashim Thaçi Nr. DV-001-2017 i datës 10.05.2017.

³ Intervistë e U.D. Presidentit z. Jakup Krasniqi, cituar sipas vegëzës së ueb-faqes së Presidencës së Republikës së Kosovës <https://president-ksgov.net/sq/intervista/krasniqi-ne-express-rruga-drejt-zgjedhjeve>, qasur për të fundit herë më 11.04.2020.

⁴ Cituar sipas lajmit të Agjencisë së Lajmeve "Deutsche Welle", nr: <https://www.dw.com/sq/shp%C3%ABrndahet-kuvendi-i-kosov%C3%ABs-zgjedhje-m%C3%AB-12-dhjetor/a-6181713>, qasur për të fundit herë më 11.04.2020.

mocioni i mosbesimit të qeverisë nuk ishte kërkuar për ta nxjerrë vendin nga kriza institucionale, mirëpo me të vetmin qëllim që ta çojnë vendin në zgjedhje të jashtëzakonshme.”

Do të më thoni që këto procese kanë ndodhur në vitin 2010, pra para marrjes së Aktgjykimit nga Gjykata Kushtetuese në rastin KO 103/14. Megjithatë rast i njëjtë sikur në vitin 2010 ka ndodhur edhe në vitin 2017 (pas Aktgjykimit të Kushtetueses), ku pas mocionit të suksesshëm të mosbesimit është shpërndarë Kuvendi dhe vendi ka shkuar në zgjedhje të reja. Edhe në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës të datës 10.05.2017, iniciuesit e mocionit të mosbesimit nuk kishin asnjë dilemë se pas votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit kishte vetëm një procedurë që duhej ndjekur dhe atë jo në Kuvend, por shpalljen e zgjedhjeve nga presidenti.

Mënyra se si është jetësuar deri tani Kushtetuta, pas një mocioni të suksesshëm mosbesimi, është në përputhje me frymën dhe shkronjën e saj, ashtu si dëshmojnë edhe deklaratat publike të anëtarëve të Komisionit për hartimin e Kushtetutës. Në mesin e tyre Prof. Dr. Arsim Bajrami i cili në vitin 2014 kishte deklaruar se *“në qoftëse opozita arrin ta rrëzojë Kryeministrin në rrugë parlamentare që ndodh në shumë vende, me mocion mosbesimi, që është instrumenti kryesor për ta rrëzuar një qeveri, për t'ia ndërprerë mandatin, për mos ta lërë për të shkuar 4 vjet por për ta ndëshkuar në vitin e parë a të dytë, e nëse opozita ka sukses, Kushtetuta jonë nuk i jep të drejtë opozitës që ajo ta bëjë Kryeministrin, por automatikisht e çon vendin në zgjedhje. Nuk jemi ne sistem i Italisë.”* Për më tepër ai vazhdon të theksojë se një konsensus për të përcaktuar zgjedhjet si alternativën e vetme kushtetuese pas mocionit të suksesshëm të mosbesimit ka qenë në koordinim edhe me juve. *“Na e kemi këtë sistem politik. Ka sisteme të tilla në vende tjera, por ne e kemi zgjedh kur e kemi shkru kushtetutën, jo vetëm ne hartuesit e kushtetutës por kanë qenë edhe ilderët me neve, ne vazhdimisht i kemi njoftu për këto sene, ka qenë një konsensus se ne po e marrim këtë sistem politik, dhe ky sistem politik është i këtij lloji, që nuk mundet me u anashkalu rezultati i zgjedhjeve dhe sa herë të dëshirohet që ky rezultat të ndërrohet me rrethana të reja në Parlament, atëherë praktikisht mund të rrëzohet Qeveria me mocion mosbesimi dhe vendi të shkojë në zgjedhje të reja.”*

E kam të qartë që situata aktuale nuk lejon mbajtjen e zgjedhjeve, dhe kjo është diçka që ne nuk po kërkojmë të bëhet tani, por sapo të krijohen kushtet pas kalimit të pandemisë. Mirëpo ajo që nuk e kam të qartë, është standardi i dyfishtë që Ju dhe partitë politike po tentoni ta impononi në rrugë jokushtetuese, pas këtij mocioni mosbesimi i cili nuk dallon në aspekt formal dhe material nga praktikat e mëhershme. Ndoshta do të mund të na sqaroni këtë?

Z. President, meqenëse prioriteti im i parë si kryeministër, si dhe prioriteti i parë i të gjithë Qeverisë të cilën e udhëheq, është parandalimi i përhapjes së mëtejshme të virusit COVID-19, çdo çështje tjetër partiake apo politike duhet konsideruar e rëndësishme dytësore apo tretësore, duke përfshirë në veçanti ndërhyrjet tuaja të vazhdueshme, të cilat po e pengojnë punën e Qeverisë në mes të një gjendjeje emergjente të shëndetit publik.

Sikur të mos mjaftonte kjo, në kohën më të papërshtatshme të mundshme, ju po kërkon që gjendjes emergjente të shëndetit publik, t'i shtoni një krizë të natyrës kushtetuese dhe politike, duke kërkuar me çdo kusht, pa asnjë mbështetje në Kushtetutë, që të hiqet Qeveria në detyrë, mu në javët më kritike të betejës sonë kundër COVID-19.

Prandaj në frymën e kësaj gjendjeje faktike dhe juridike besoj se edhe Ju e keni tani të qartë që nuk është detyrë e Presidentit që të imponohet me shkresa duke kërkuar emra kandidatësh për Kryeministër. Sidomos jo në një periudhë të emergjencës shëndetësore. Por më lejoni të theksoj, se kjo shkresë nuk është refuzim për të ju dhënë një emër të kandidatit për Kryeministër. Është një rikujtim i kornizës së kompetencave tuaja dhe obligimeve kushtetuese që bien mbi institucionin e Presidentit të Republikës së Kosovës, pas një mocioni të suksesshëm mosbesimi, sepse nuk është në diskrecionin tuaj që të impononi skenarë jokushtetues. Po ashtu, përpos që është edhe një përkujtim se shëndeti i qytetarëve të Republikës së Kosovës është prioriteti im dhe i Qeverisë, është ftesë që edhe Ju ta vendosni si prioritetin tuaj duke lënë mënjanë lojërat politike dhe duke mos rrezikuar më jetën dhe shëndetin e qytetarëve tonë.

Me respekt,



Albin Kurti
Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës



telegرافي.com



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Datë: 17.04.2020

Ref: 122/2020

I nderuar President,

Jo, nuk hezitojmë t'ju përgjigjemi.

Jo, nuk e refuzojmë kërkesën tuaj.

Por jam i detyruar të përsëris atë që kam pyetur në letrën time të fundit, e për të cilën nuk kam marrë përgjigje. Shprehimisht kam thënë: *E kam të qartë që situata aktuale nuk lejon mbajtjen e zgjedhjeve, dhe kjo është diçka që ne nuk po kërkojmë të bëhet tani, por sapo të krijohen kushtet pas kalimit të pandemisë. Mirëpo ajo që nuk e kam të qartë, është standardi i dyfishtë që Ju dhe partitë politike po tentoni ta impononi në rrugë jokushtetuese, pas këtij mocioni mosbesimi i cili nuk dallon në aspekt formal dhe material nga praktikat e mëhershme. Ndoshita do të mund të na sqaroni këtë?*

Unë kam kërkuar sqarim lidhur me këtë, dhe jam akoma në pritje të përgjigjes suaj.

Po ashtu, ju lutem ta specifikoni bazën juridike sipas të cilës po veproni, sepse neni 95 të cilit i referoheni ka gjashtë paragrafe të cilat rregullojnë çështje të ndryshme nga njëra-tjetra, dhe referimi paushall në nenin 95 nuk është i justifikueshëm në këtë moment.

Do të jem në pritje të sqarimit tuaj, me shpresën se do të përdorni standardin e njëjtë që po pritni nga unë. Pas përgjigjes suaj mbase mund ta kem më të qartë arsyen pas këtij insistimi për t'u marrë me çështje dytësore e tretësore, në një kohë kur të gjithë duhet të bashkohemi në luftën kundër armikut të përbashkët - COVID-19.

Me respekt,

Albin Kurti

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Datë: 22.04.2020

Ref: 135/2020

I nderuar President,

Përkundër që në asnjë rast nuk kemi refuzuar as kërkesën dhe as propozimin e mandatarit, sot, më 22.04.2020, kam pranuar një letër nga ju, përmes të cilës konstatooni jashtë kompetencave tuaja kushtetuese si President, se unë nuk e paskam shfrytëzuar të drejtën për propozimin e kandidatit të ri për të formuar Qeverinë.


Kushtetuta e Republikës nuk parasheh një kompetencë të tillë të Presidentit për të vlerësuar apo konstatuar shfrytëzimin apo mosshfrytëzimin e të drejtës për të propozuar mandatarin. Përveç kësaj, Kushtetuta e as Aktgjykimi Nr. 103/14 nuk kanë përcaktuar as afatin për një gjë të tillë. Kushtetuta çfarë parasheh në këtë rast është caktimi i mandatarit vetëm pas propozimit nga partia ose koalicioni që ka fituar shumicën absolute apo relative, siç përcaktohet edhe në pikën 84 të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese.

Andaj, bazuar në rolin dhe funksionin si President, ju nuk keni të drejtë e as autorizim kushtetues për të konstatuar se kemi refuzuar propozimin e kandidatit për kryeministër kur nuk e kemi bërë këtë; ju nuk e keni në mandat e kompetencë që të përcaktoni përtej Kushtetutës se si e çfarë do të jetë Qeveria, siç keni bërë këtyre ditëve në deklaratimet publike; dhe, me keqardhje konstatojmë se ende nuk na jeni përgjigjur se në bazë të cilës pikë të nenit 95 po veproni dhe po na drejtoheni.

Me respekt,

Albin Kurti

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PRESEDNIK

30.03.2020

Z. Albin Kurti,
Kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje

I nderuar z. Kurti,

Pas mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë (Vendimi i Kuvendit Nr. 07-V-013, 25.03.2020) do të ndërmarrë hapat e përcaktuar në Kushtetutë.

Në këtë drejtim, Ju ftoj që të merrni pjesë në takimin konsultativ për të diskutuar hapat e mëtejshëm.

Takimi do të mbahet më datën 01.04.2020, duke filluar nga ora 10:00, në Kabinetin e Presidentit të Republikës së Kosovës.

Me respekt!

Hashim THACI

President i Republikës së Kosovës



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PREDSIEDNIK

REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PREDSIEDNIK

No. Protokoll: 354
Datë: 02.04.2020

02.04.2020

Z. Albin Kurti,

Kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje

Inderuari z. Kurti,

Pas mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë (Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 07-V-013, të datës 25.03.20120), në pajtim me nenin 95 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, do të ndër marrë hapat e nevojshëm për caktimin e mandatarit për formimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Duke marrë parasysh Nenin 95 të Kushtetutës, Vendimin e Gjykatës Kushtetuese KO103/14, të datës 1 korrik 2014, dhe Vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për certifikimin e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 6 tetor 2019 (Protokoll i KQZ-së nr. 1845-2029, 27.11.2019), Lëvizja Vetëvendosje, është subjekti politik që ka fituar shumicën në Kuvend për të formuar Qeverinë dhe ka të drejtën e propozimit të kandidatit të ri, për të formuar Qeverinë.

Ju lutem, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, propozoni kandidatin e ri, të cilin do të mandatoj për formimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Me respekt!

Haslim PRACI

President i Republikës së Kosovës



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PRESEDNIK

REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PRESEDNIK

Pr. Post. 353
Pr. Post. 02.04.20
Pr. Post. 02.04.20
KOSOVINEA

02.04.2020

Z. Albin Kurti,
Kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje

I nderuari z. Kurti,

Ishte kënaqësi që u takuam dje dhe ju falënderoj për qëndrimin tuaj të qartë dhe transparent.

Njëkohësisht, Ju falënderoj për të dy letrat që i keni dërguar dje (01.02.2020-Ref.108/2020).

Takimi i djeshëm me ju (01.04.2020), pas mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë (Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 07-V-013, të datës 25.03.20120), ka qenë takim konsultues me Kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje - liderin e partisë së parë sipas rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 6 tetor 2019. Pra, ka qenë një takim i karakterit formal, juridik e procedural, për konsultim për të vlerësuar nëse është në interesin e partisë politike që përfaqësoni ju formimi i Qeverisë së re apo shpërndarja e Kuvendit.

Sic e theksova edhe në takim, si President i vendit, dëshiroj të Ju siguroj që hapat e mi të më tutjeshëm do të jenë në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

Me respekt!

Hashim THAJCI

President i Republikës së Kosovës



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PREDSEDNIK

354/1 10.04.20

10.04.2020

Z. Albin Kurti,
Kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje

I nderuar z. Kurti,

Jam në pritje të përgjigjes suaj në kërkesën që ua kam përcjellë më datë 2 prill 2020 (Ref. 354, 02.04.2020), për të propozuar kandidatin/en për Kryeministër dhe formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës pas mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë (Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 07-V-013, të datës 25.03.2020).

Ju rikujtoj që Lëvizja Vetëvendosje, në pajtim me Nenin 95 të Kushtetutës, Vendimin e Gjykatës Kushtetuese KO103/14, të datës 1 korrik 2014 dhe Vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për certifikimin e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 6 tetor 2019 (Protokoll i KQZ-së nr. 1845-2019, 27.11.2019), është subjekti politik që ka fituar shumicën në Kuvend për të formuar Qeverinë dhe ka të drejtën e propozimit të kandidatit/es të ri/re për të formuar Qeverinë.

Siç e dini, pas mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë të datës 25.03.2020, kam zhvilluar takime konsultative me të gjitha partitë politike të përfaqësuara në Kuvend për të vlerësuar nëse është në interesin e partive politike formimi i Qeverisë së re apo shpërndarja e Kuvendit. Shumica e partive politike janë deklaruar që janë për formimin e Qeverisë së re.

Në këtë drejtim, duke marrë parasysh aktet e sipërpërmendura ua kam dhënë mundësinë që si Lëvizje Vetëvendosje të propozoni kandidatin/en e ri për Kryeministër.

Qytetarët e Republikës së Kosovës dhe partitë politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës, me të drejtë presin funksionalizimin e Qeverisë së re dhe presin nga unë të dekretoj kandidatin/en e propozuar për Kryeministër.

Edhe një herë më duhet t'ua rikujtoj se mandati im kushtetues më obligon që të garantoj funksionimin demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe sigurimin e emërimit të kandidatit/es të ri/re për Kryeministër për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës. Si President i Republikës së Kosovës unë do ta ndër marr këtë veprim, duke ndjekur të gjithë hapat kushtetues që qytetarët e Republikës së Kosovës të kenë sa më shpejt Qeverinë e tyre të re.

Luteni që në emër të Lëvizjes Vetëvendosje të propozoni kandidatin/en e ri/re për Kryeministër, të cilin do të mandatoj për formimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës.


Me respekt,

Hashim THACI

President i Republikës së Kosovës



REPUBLIKA E KOSOVËS -- PRËSDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO -- THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO -- PREDSEDNIK



15.04.2020

Z. Albin Kurti,
Kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje

I nderuar z. Kurti,

Më datë 13.04.2020 (Ref.: 120/2020) kam pranuar një letër nga ju, ku u jeni referuar shkresave që ua kam dërguar juve në cilësinë e Kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje. Në këtë shkresë ju nuk keni propozuar kandidatin/en për Kryeministër, por as nuk keni refuzuar një gjë të tillë. Duke marrë parasysh kërkesat që ua kam përcjellë më datë 2 prill 2020 (Ref. 354, 02.04.2020) dhe më datë 10 prill 2020 (Ref. 354/1, 10.04.2020), përsëri ua rikujtoj se jam në pritje të përgjigjes suaj për të propozuar kandidatin/en për Kryeministër për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës, pas mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë (Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 07-V-013, të datës 25.03.2020).

Ju rikujtoj që mandati im kushtetues më obligon që të garantoj funksionimin demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe sigurimin e emërimit të kandidatit/es për Kryeministër për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës. Qytetarët e Republikës së Kosovës dhe partitë politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës, me të drejtë presin funksionalizimin e Qeverisë së re, si dhe presin nga Presidenti të caktojë mandatarin për formimin e Qeverisë.

Si President i Republikës së Kosovës do ta ndër marr këtë veprim duke ndjekur të gjithë hapat kushtetues, që qytetarët e Republikës së Kosovës të kenë sa më shpejtë Qeverinë e tyre të re,


sidomos në këtë situatë të pandemisë COVID 19, e cila kërkon një qeveri efikase dhe efektive me mandat të plotë kushtetues.

Askush nuk ka të drejtë t'i privojë përfaqësuesit e zgjedhur të popullit në Kuvendin e Republikës së Kosovës për të pasur kandidatin/en për Kryeministër dhe për të ushtruar kompetencën e tij/saj për të zgjedhur Qeverinë e Republikës së Kosovës, siç përcaktohet në nenin 65 (8) të Kushtetutës. Vonesa e juaj në propozimin e kandidatit/es për Kryeministër i pamundëson Kuvendit për të zgjedhur Qeverinë dhe rrjedhimisht pamundëson edhe funksionimin demokratik dhe kushtetues të institucioneve, që sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës duhet ta garantojë Presidenti.

Duke pasur parasysh edhe Pikën 87 të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. KO103/14, Gjykata Kushtetuese "vëren se nuk përjashtohet që partia ose koalicioni në fjalë do të refuzojë të marrë mandatin", atëherë duhet ta keni në konsideratë se nëse ju nuk e propozoni kandidatin/en për Kryeministër, atëherë veprimet tuaja mund të reflektojnë edhe hezitim në marrjen e mandatit, respektivisht refuzimin e marrjes së mandatit.

Në fund, kërkoj përsëri nga ju që të bëni propozimin për kandidatin/en për Kryeministër pa humbur kohë dhe në përputhje me nenin 95 të Kushtetutës dhe Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. KO103/14. Unë ju siguroj se brenda një periudhe të arsyeshme kohore, në përputhje me urgjencën për t'i dhënë vendit Qeveri të re me legjitimitet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, do të propozojë kandidatin/en për Kryeministër për të formuar Qeverinë.

Me respekt,



Hasnim Thaçi

President i Republikës së Kosovës



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PREDSIEDNIK

REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT REPUBLIKA KOSOVO – PREDSIEDNIK	
No. Protokollit Prot. No.	390/3
Data Data	17. 04. 2020
PRESIDENTI	

17.04.2020

Z. Albin Kurti,
Kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje

I nderuar z. Kurti,

Më datë 17.04.2020 (Ref. 122/2020), kam pranuar edhe një letër nga ju, ku u jeni referuar shkresave që ua kam dërguar juve në cilësinë e Kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje.

Përkundër kërkesave të dërguara më 2 prill 2020 (Ref. 354), më 10 prill 2020 (Ref. 354/1) dhe më 15 prill 2020 (Ref. 370/1), edhe në shkresën tuaj të dërguar më 17 prill 2020 (Ref. 122/2020), ju nuk keni propozuar kandidatin/en për Kryeministër, por keni theksuar se nuk jeni duke refuzuar për të propozuar kandidatin për kryeministër. Më lejoni t'ua theksoj se mosrefuzimi nga ana juaj nënkupton që ta dërgoni emrin e kandidatit/es për Kryeministër. Por, ju nuk e keni bërë ende këtë, përkundër faktit që ua kam dërguar tri kërkesa për këtë qëllim.

Prandaj, edhe një herë, në përputhje me nenin 95 të Kushtetutës dhe Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. K0103/14, kërkoj ta dërgoni emrin e kandidatit/es për Kryeministër pa humbur kohë.

Me respekt,


Hashim Thaci
President i Republikës së Kosovës

REPUBLIKA E KOSOVËS - PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO - THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - PRESEDNIK

№ Prodi: 380
№ Qendror: 22.04.2020
№ Post. Qendror: 2020

PRELETENËJA



REPUBLIKA E KOSOVËS - PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO - THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - PRESEDNIK

22.04.2020

Z. Albin Kurti,
Kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje

I nderuar z. Kurti,

Përkundër kërkesave që ua kam dërguar më 2 prill 2020 (Ref. 354), më 10 prill 2020 (Ref. 354/1), më 15 prill 2020 (Ref. 370/1) dhe më 17 prill 2020 (Ref. 370/3), ju nuk e keni propozuar kandidatin/en për Kryeministër.

Me keqardhje konstatoj se me veprimet tuaja nuk e keni shfrytëzuar të drejtën tuaj të propozimit të kandidatit të ri për ta formuar Qeverinë, në pajtim me Vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për certifikimin e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Më duhet t'ju rikujtoj që në pajtim me mandatin kushtetues të Presidentit të Republikës së Kosovës është përgjegjësi e imja që ta ruaj stabilitetin e vendit dhe ta garantoj funksionimin demokratik të institucioneve të vendit.

Prandaj, në përputhje me nenin 95 të Kushtetutës dhe Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. K0103/14 do të bëj konsultim të përbashkët me të gjithë liderët e subjekteve politike parlamentare për hapat e mëtejshëm.

Me respekt,

Hashim Thaçi

President i Republikës së Kosovës